

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
JANAR - DHJETOR 2025

Nr. Ren dor	Data e kërkesë s	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarif a
----------------------------	---------------------------------	---------------------------	------------------------------	------------------	---	--------------------

1	26.12.2024	Referuar dëmit që po shkakton, prej disa vitesh, një insekt i dëmshëm ndaj masivit pyjore të gështenjës, kam nevojë për këto të dhëna, 1. Cilat janë zonat e prekura (fshatrat, pyjet, shtigjet etj) dhe sa hektarë janë prekur në secilën zonë të përshkruar? 2. Ju lutem, sipërfaqen totale për secilën zonë dhe shkallën e prekjës së këtij volumi (Pra, raportin mes tyre). 3. Në ç'vit hyri insekti i dëmshëm në Shqipëri? Në cilën zonë u shfaq në fillim; si progresoi më tej? 4. A keni një raport, apo një dokument që përshkruan këtë historik; nëse po, ju lutem të ma dërgoni (Nëse keni një vlerësim sesa ka rënë prodhimi në pesë vitet e fundit). 5. Lidhur më insektin e dëmshëm që ka prekur	21.1.2025	 pergjigje.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
---	------------	--	-----------	---	----------------------------------	---

	gështenjën, a keni kryer monitorime vjetore? Nëse po, a mund të më dërgoni rezultatet e monitorimeve? 6. Sa është shuma e përgjithshme e shpenzuar, nga 2018, për rikuperimin e pyjeve të dëmtuara? Ju lutem, të m'i shpërndani sipas zërave dhe sipas viteve në të cilat janë përdorur. 7. Cila janë sipërfaqet e trajtuara (sa hektarë dhe për çfarë trajtimi bëhet fjalë, konkretisht? Pra, fjala është jo vetëm për të luftuar insektin, por edhe shërbime të tjera: pastrim, krasitje, mirëmbajtje fondi pyjor etj. 8. Cilat janë projektet (në bashkëpunim me organizatat apo grupet e mëdha financiare: BB, BE, FAO etj) që keni zhvilluar për trajtimin e këtij problemi? 9. Si funksionon sistemi i karantinimit të farave dhe fidanëve që futen për herë të parë në në Shqipëri dhe në ç'rrethana u lejua futja e fidanit të kontaminuar të gështenjës? 10. Sa para shpenzohen për karantinimin e fidanëve të rinj? 11. Si është organizuar				
--	--	--	--	--	--

		struktura për karantinimin, numri i specialistëve dhe detyrat që ndajnë? 12. Sa fidanë gështenje futen çdo vit në Shqipëri? Sa janë futur nga 2018 e këtej? Nga cilat vende vijnë? A janë evidentuar fidanë të kontaminuar? Nga cilat vende kanë ardhur fidanët e kontaminuar? 13. A parashikoni fonde nga taksapaguesit për administrimin e pyjeve të gështenjës në pesë vitet e ardhshme? Konkreisht, për cilat zëra?				
--	--	--	--	--	--	--

2.	6.1.2025	Per efekte administrative dhe gjyqesore kerkojme nje informacion nese insitucioni juaj merret me privatizimin e truallit sipas ligjit 18/2023 apo per këtë procedure merret ASHK?	21.1.2025	Ne pergjigje te emailit tuaj bej me dije se referuar nenit 7 te ligjit 18/2023 Ministria pergjegjese per bujqësinë dhe agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor janë autoritetet publike pergjegjese per zbatimin e këtij ligji, me qëllim përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ishndërmarrjeve bujqësore dhe trojeve të tyre funksionale. Gjithashtu bej me dije se referuar pikes 2 te nenit 4 te ketij ligji <i>Fusha e zbatimit të këtij ligji shtrihet edhe mbi truallin funksional të objekteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni në rastet kur ky truall nuk është privatizuar më parë, është ende në pronësi shtetërore, si dhe nuk përbën pronë publike të patjetërsueshme në kuptim të legjislacionit për pronat e paluajtshme të shtetit. Në fushën e zbatimit përfshihen edhe rastet</i>		
----	----------	---	-----------	--	--	--

				<i>kur për këtë truall është lidhur kontratë shitjeje pa akt noterial mes subjektit dhe AQRPN-së.</i> Ne vitin 2024 u miratua vendimi i Keshillit te Ministrave 858, date 26.12.2024 "Per percaktimin e dokumentacionit per përfundimin e procesit te privatizimit menyren e perllogaritjes se vleres se pageses se mbetur dhe afatet e pageses se privatizimit te objekteve te ish ndermarrjeve bujqesore", bashkelidhur.		
--	--	--	--	--	--	--

3.	8.1.2025	· Si është përzgjedhur kompania për ndërtimin e argjinaturave në lumin Drinos? · Kopje të kontratës me shoqërinë “2N” shpk; · Kopje të projektit për ndërtimin e argjinaturave në lumin Drinos? · Kopje të lejes/lejeve të dhëna për ndërtimin e argjinaturave në lumin Drinos.	22.1.2025	 Kthim pergjigje - Copy.doc  deklarate fillim  projektii miratuar  leja mjedisore Gjirokater.pdf  vnm thelluar Fabrika e kepuceve,G  punimesh Gjirokastene AKZM mbrojtja ng	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
4.	9.1.2025	1- Na vini në dispozicion të dhënat për analizat që ministria e Bujqësisë dhe agjencitë nën varësi të saj (AKU dhe AKVMB) kanë kryer gjatë vitit 2024 për frutat dhe perimet që prodhohen në vendin tonë. 2- Na vini në dispozicion listën e pesticideve të ndaluara që janë konstatuara nga këto analiza (sipas viteve) dhe	29.1.2025	 kthim pergjigje.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		konkretisht në cilat fruta dhe perime janë përdorur këto pesticide të ndaluara. 3- Na vini në dispozicion të dhënat për analizat që ministria e Bujqësisë dhe agjencitë nën varësi të saj kanë kryer në 5 vitet e fundit për frutat dhe perimet që prodhohen në vendin tonë. 4- Na vini në dispozicion dokumente për masat që janë marrë nga ministria apo agjencitë nën varësi të saj në bazë të rezultateve të analizave apo inspektimeve të tjera të kryera. 5- Na vini në dispozicion listën e plotë zyrtare të pesticideve që nuk lejohen të përdoren nga fermerët shqiptarë. 6- Na vini në dispozicion dokumente mbi inspektimet e kryera nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve që nga krijimi i kësaj agjencie dhe rezultatet e këtyre inspektimeve. 7- Na vini në dispozicion dokumente mbi inspektimet e kryera nga Agjencia Kombëtare e Ushqimit për vitin e fundit				
--	--	--	--	--	--	--

		(2024) dhe rezultatet e këtyre inspektimeve.				
--	--	--	--	--	--	--

5.	9.1.2025	A ka pasur nga laboratorë privat raste të konstatimit të pesticideve në produktet që subjektet e ndryshme kanë çuar për autokontroll pranë këtyre laboratorëve? Nëse ka pasur raste të tilla, për çfarë pesticidesh bëhet fjalë? Në çfarë periudhe dhe në cilat zona dhe cilat subjekte?	29.1.2025	Pas koordinimit të kësaj kerkese me AKU ju bejme me dije se AKU si organi përgjegjës për garantimin e sigurisë ushqimore në vend, nuk disponon informacion mbi rastet e konstatimit të pesticideve në produktet që subjekte të ndryshme kanë çuar për autokontroll pranë laboratorëve privatë që ushtrojnë aktivitetin e tyre si subjekte të akredituara për kryerjen e këtyre analizave. Megjithatë, në kuadër të garantimit të sigurisë ushqimore në vend, AKU ka kërkuar informacion me shkresë zyrtare pranë laboratorëve privatë të akredituar për kryerjen e këtyre analizave, ku kanë bërë bërë me dije se, nuk mund japin një informacion të tillë, pasi konfidencialiteti referuar akreditimit që ata disponojnë, si dhe marrëdhëniet kontraktuale që kanë me klientët e tyre e ndalon dhënien e informacionit.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
6.	14.1.2025	1. Një kopje e shkresës nr.7659/2, datë 4.12.2024, të Ministrisë së Bujqësisë.	27.1.2025	 7659.2.pdf	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

7.	24.1.2025	Rezultatet e analizave te kryera ne baze te urdherit nr.365 date 19/06/2023 “Per monitorimin e perdorimit te qendrueshem te produkteve te mbrojtjes se bimeve (PMB) ne ferme”. Na vini ne dispozicion raportin e plote te ketyre analizave, listen e pesticideve te ndaluara te konstatuara ne mostrat e marra per analize ne baze te ketij urdheri.	7.2.2025	 pergjigje.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
----	-----------	--	----------	---	----------------------------------	---

8.	28.1.2025	Sa është numri i SHoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor të regjistruara? Numri i punonjësve dhe xhiro vjetore për secilën prej tyre?	28.1.2025	Ne lidhje me informacionin e kerkuar bejme me dije se referuar ligjit 38/2012 "Per shoqerite e bahskepunimit bujqesor", keto shoqeri regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit”.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
----	-----------	--	-----------	---	----------------------------------	---

9.	29.1.2025	A ka Ministria e Bujqësisë një vlerësim për projektet që janë bllokuar për shkak të mosakordimit të fondeve të programit IPARD II? 2. Duke qenë se BE-ja mban të bllokuar fondet për zhvillimin e programit IPARD III, a keni një vlerësim për pasojat që ky vendim do të shkaktojë në sektorin e bujqësisë? 3. Nisur nga korrespondenca që ju mund të keni me institucionet e BE-së, a jeni informuar mbi kohën kur mund të realizohet zhbllokimi i këtyre fondeve.	11.2.2025	 pergjigja.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
10.	4.2.2025	1. Listën e subjekteve që kanë përfituar toka me qira në periudhën 2015-2024, ku për cdo subjekt të jetë përcaktuar vlera financiare dhe sipërfaqja e tokës me qira.	19.2.2025	Duke arsyetuar bazueshmërinë e kësaj kërkesë për informim, e drejta për informim vlerësohet si një e drejtë themelore në një shtet demokratik, dhe vullneti i qeverisë për ta përmbushur këtë të drejtë është demonstruar me miratimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, dhe standartizimi i së cilës edhe me miratimin/ratifikimin me ligjin nr. 45/2022 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”. Sipas këtyre normave garantohet e drejta për t’u njohur me dokumente zyrtare që prodhohen ose	Refuzuar.	0

				mbahen nga autoritetet publike. E drejta për informim për dokumentat zyrtare, sipas standarteve të miratuara europiane konsiston dhe ka si qëllim nxitjen e integritetit, efektshmërinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike, duke i ndihmuar në këtë mënyrë që të konfirmojnë legjitimitetin e tyre si dhe ndihmon publikun në formimin e një opinion për gjendjen e shoqërisë dhe autoritetet publike. Kërkesa që ju parashtroni për të vendosur në dispozicion listën e subjekteve që kanë përfituar toka me qira, sipërfaqen e tokës dhe vlerën për vitet 2015-2024 dhe listën e pronave të kthyera nga tokë bujqësore në truall për vitet 2015-2024, përveçse qëllim kurioziteti nuk realizon asnjë nga qëllimet për të cilat janë garantuar këto të drejta nga ligji apo nga standartet e ratifikuara evropiane. Për rrjedhojë, kërkesa konsiderohet e paarsyeshme dhe bazuar në nenin 5 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentat zyrtare” ratifikuar me ligjin nr. 45/2022, kërkesa refuzohet		
11.	11.2.2025	1. Listën e plotë të pronave të kthyera nga tokë bujqësore në tokë truall për vitin 2015-2024 dhe hartat përkatëse me ndryshimet për secilin vendim.	19.2.2025	Duke arsyetuar bazueshmërinë e kësaj kërkesë për informim, e drejta për informim vlerësohet si një e drejtë themelore në një shtet demokratik, dhe vullneti i qeverisë për ta përmbushur këtë të drejtë është demonstruar me miratimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, dhe standartizimi i së cilës edhe me miratimin/ratifikimin me ligjin nr. 45/2022 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”. Sipas këtyre normave garantohet e drejta për t’u njohur me dokumente zyrtare që prodhohen ose mbahen nga autoritetet publike. E drejta për informim	Refuzuar	0

				për dokumentat zyrtare, sipas standarteve të miratuara europiane konsiston dhe ka si qëllim nxitjen e integritetit, efektshmërinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve publike, duke i ndihmuar në këtë mënyrë që të konfirmojnë legjitimitetin e tyre si dhe ndihmon publikun në formimin e një opinion për gjendjen e shoqërisë dhe autoritetet publike. Kërkesa që ju parashtroni për të vendosur në dispozicion listën e subjekteve që kanë përfituar toka me qira, sipërfaqen e tokës dhe vlerën për vitet 2015-2024 dhe listën e pronave të kthyer nga tokë bujqësore në truall për vitet 2015-2024, përveçse qëllim kurioziteti nuk realizon asnjë nga qëllimet për të cilat janë garantuar këto të drejta nga ligji apo nga standartet e ratifikuara evropiane. Për rrjedhojë, kërkesa konsiderohet e paarsyeshme dhe bazuar në nenin 5 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentat zyrtare” ratifikuar me ligjin nr. 45/2022, kërkesa refuzohet		
--	--	--	--	---	--	--

12.	5.2.2025	Kërkoj të pajisem në rrugë elektronike me vendimet e mëposhtme: 1) Vendim i Këshillit të Ministrave 173 viti 1992 2) Vendim i Këshillit të Ministrave 270 viti 1993 3) Vendim i Këshillit të Ministrave 448 viti 1993 4) Vendim i Këshillit të Ministrave 111 viti 1993 5) Vendim i Këshillit të Ministrave 112 viti 1993	19.2.2025	Pas shqyrtimit te kerkeses suaj per informim rezulton se nuk disponojme vendimet e kerkuara, me perjashtim te vendimit nr. 331/1995 i cili eshte i publikuar ne QBZ. Me poshte do te gjeni linkun. https://qbz.gov.al/eli/vendim/1995/06/26/331/1c386427-931f-400f-bc5a-c485e36d1ca3 Per vendimet e tjera mund ti drejtoheni arkivit shteteror.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
-----	----------	--	-----------	---	----------------------------------	---

		6) Vendim i Këshillit të Ministrave 175 viti 1995 7) Vendim i Këshillit të Ministrave 331 viti 1995				
13.	5.2.2025	A ka hyrë në fuqi rregullorja që ndalon importin nga Brazili të mishit të dërrit me ractopamine?	19.2.2025	 Pergjigje.docx  Urdher nr 357 date 22.12.2011.pdf	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
14.	8.2.2025	Të na vini në dispozicion listen e PMB-ve të regjistruara në Shqipëri/	19.2.2025	Lista e PMB-ve të regjistruara për t'u tregtuar dhe përdorur ne Shqiperi, është e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: https://bujqesia.gov.al/lista-e-pmb-ve-te-regjistruara Lista e fundit e publikuar eshte e dhjetorit 2024.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

15.	14.2.2025	• A ka Ministria e Bujqësisë një studim mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në sektorin bujqësor, veçanërisht mbi kultura të rëndësishme si fasulja? • Cilat janë zonat më të prekura nga thatësira dhe temperaturat e larta në Shqipëri? • A keni një vlerësim për humbjet ekonomike në sektorin bujqësor për shkak të këtyre ndryshimeve? • Çfarë masash janë ndërmarrë ose planifikohen për të ndihmuar fermerët të përshtaten me kushtet e	28.2.2025	 pergjigja (2).docx	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
-----	-----------	--	-----------	---	----------------------------------	---

		reja klimatike? • A ka mbështetje financiare ose subvencione për fermerët që pësojnë humbje nga thatësira ose temperaturat e larta? • A është menduar për investime në sisteme ujitjeje më efikase apo mbështetje për kultivimin e varieteteve më rezistente ndaj ndryshimeve klimatike? • A ka plane për të orientuar fermerët drejt kulturave më të përshtatshme për klimën e re				
16.	18.2.2025	Lutem nga ana juaj vënien në dispozicion të dhënave dhe mëposhtme: 1- Organigramën e drejtorisë/zyrës së komunikimit 2- Numrin e punonjësve me kontratë të plotë për komunikimin dhe pozicionin përkatës (p.sh.: Specialist për media /specialist për faqen e internetit / kameraman fotograf etj.). 3- Numrin e punonjësve me kontratë të përkohshme për sektorin e komunikimit dhe pozicionin përkatës 4- Fondin vjetor të alokuar për këtë sektor për vitet 2022, 2023, 2024, 2025 dhe mënyrën e shpërndarjes së tij (p.sh.:	6.3.2025	Ne funksion të transparencës, ju bejme me dije se në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 61, datë 18.4.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, MBZHR nuk rezulton të ketë strukture të dedikuara për Komunikimin etj, për cka kërkohej nga ana juaj.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		Fondi i pagave, fondi për aktivitete publike etj.) 5- Sa ka ndryshuar numri i punonjësve për Drejtorinë/zyrën e komunikimit për vitet 2021, 2022, 2023, 2024, 2025.				
17.	27.2.2025	- Cili është statusi i programit të fondit IPARD leshuar nga Komisioni Europian? - A keni një përgjigje nga Komisioni Evropian lidhur me raportin e dorëzuar për programin IPARD III? Nëse po, cilat janë pikat kryesore që adreson raportin? - Gjithashtu, ju lutem mund të dërgoni linkun ose dokumentin bashkëngjitur mbi raportimet që MBZHR-se në lidhje me programin IPARD?	10.3.2025	Programi IPARD II 2014 – 2020 ka përfunduar zbatimin e tij në 31 dhjetor 2024. Programi IPARD III është miratuar me Vendim të Komisionit C(2022) 1539, datë 9 Mars 2022 “Për miratimin e programit IPA III të Zhvillimit Rural (IPARD III) të Republikës së Shqipërisë për vitet 2021-2027). Zbatimi i programit IPARD III nuk ka filluar ende. Të gjitha materialet në lidhje me Programin IPARD III të aksesueshme për publikun janë të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: https://bujqesia.gov.al/ipard-iii2021-2027/ Për informacione në lidhje me Programin IPARD mund të konsultoni faqen zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - https://www.bujqesia.gov.al/; dhe faqen zyrtare të Programit IPARD - https://ipard.gov.al/.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

18.	27.2.2025	-Sa ferma private janë shndërruar në njësi biznesi të qendrueshme fitimprurëse? -Çfarë masash janë marrë për të garantuar të drejtën e pronësisë së tokës dhe regjistrimin e saj dhe sa regjistrime janë bërë? -Çfarë stimuljsh fiskalë janë zbatuar për të stimuluar zhvillimin e agrobiznesit?	20.3.2025	E drejta e informimit është një e drejtë e cila sanksionohet në nenin 23, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe vlerësohet si një e drejtë themelore në një shtet demokratik. Vullneti i qeverisë për të përmbushur këtë të drejtë është shprehur me miratimin e ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, standartizimi i së cilës sigurohet edhe me ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës nëpërmjet miratimit të ligjit Nr.	Përgjigja i është refuzuar	0
-----	-----------	---	-----------	---	----------------------------	---

		-Çmimi i naftës për litër që është shitur për përdoruesit bujqësorë dhe sa përfitues ka pasur për periudhën e sipërpërmendur? Sasia e naftës së shitur për këta përdorues. - A përfitojnë anijet e peshkimit nga skema e naftës pa akcizë? Nga cili vit ka nisur të aplikohet? Sa subjekte përfitojnë? -A ka sot vendi ynë një rrjet shkollash të arsimit bujqësor? Kur janë hapur ? Ku janë të vendosura? Sa studentë janë diplomuar në këto shkolla dhe çfarë statistikash punësimi disponojnë për ta? - Çfarë hapash janë marrë për zgjerimin e sistemit të kreditimit dhe sa fermerë kanë përfituar prej tij? - Çfarë është bërë për zbatimin e Ligjit Nr. 7501? A ka marrë ky ligj sot zbatimin e plotë? -Të dhëna mbi prodhimin bujqësor dhe blegtoral në Shqipëri për periudhën e kërkuar. Sa është buxheti I alokuar për to dhe si është bërë shpërndarja? A ka pasur mbështetje nga fonde , programe sisteme të tjera? - A ka sot vendi ynë një sistem të plotë dhe funksional të vaditjes së tokave? Nëse po kur është nisur dhe kur ka përfunuar? Vlera e ndërtimit të sistemit. Nëse jo	45/2022 “Për aksesin në dokumente zyrtare”. Ligji për të drejtën e informimit ka për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacionin e cdo autoriteti publik. Gjithashtu, qëllimi i ligjit për aksesin në dokumentat zyrtare konsiston në plotësimin e kuadrit ligjor për të garantuar të drejtën e aksesit në dokumente zyrtare. E drejta e qasjes në dokumente zyrtare gjithashtu forcon legjitimitetin e autoriteteve publike në sytë e publikut dhe besimin e tij në to. Nëpërmjet kërkesës që ju parashtroi kërkohet informacion, të dhëna, dokumenta, statistika etj për një periudhë të gjatë kohore (2004-2025), pra rreth 25 vite. Edhe pse sipas normave ligjore garantohej e drejta për t’u njohur me informacione ose dokumente zyrtare që prodhohen ose mbahen nga autoritetet publike, mbledhja dhe përpunimi i informacionit të kërkuar është jo koherent me qëllimin e legjisllacionit për të drejtën e informimit. Kjo sepse në një periudhë të gjatë kohore si 25 vjet, përmbushja e kërkesës kërkon një analizë të thelluar dhe mund të kërkojë burime të konsiderueshme, si në kohë, ashtu edhe në staf, për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat e kërkuara. Për më tepër, ligji thekson se autoritetet publike kanë detyrimin të ofrojnë informacion publik që është në dispozicion dhe që është krijuar ose mbajtur nga ato, por ato nuk janë të detyruara të kryejnë kërkime apo hulumtime të reja për të përmbushur kërkesat. Për këtë arsye, kërkesa që ju parashtroi që përfshin pyetje të shumta dhe të ndryshme, pa një lidhje të qartë mes tyre, mund të konsiderohet si një kërkesë për studim apo analizë, që nuk është në përputhje me qëllimin e ligjit për transparencë dhe informim të drejtpërdrejtë. Kërkesa		
--	--	---	---	--	--

		aktualisht në cilat zona bëhet vadija dhe me çfarë mënyre?				
--	--	---	--	--	--	--

	Çfarë projektesh infrastrukturore janë ndërmarrë për ndërtimin e sistemit të ri të vaditjes? Vlera dhe burimi i investimit? -A furnizohet sot me ujë 24 orë çdo parcelë e tokës bujqësore të punueshme? Sa është sipërfaqja që mbulohet? Cilat zona specifikisht mbulohen? - Sa është vlera e investimeve për sistemin e kullimit dhe vaditjes për periudhën e kërkuar? -Si është bërë mbrojtja e tokës nga kalbëzimi dhe erozioni? Projektete e zbatuara dhe kostot përkatëse. Sipërfaqja e tokës mbi të cilën është aplikuar dhe ku ndodhet konkretisht? - Sa hektarë tokë të braktisur janë rikuperuar përmes sistemit të të dhjetës? Sa përdorues kanë përfituar? - Çfarë suksesi është vënë re nga programet që synojnë mbjelljen e 20 milionë pemëve ullinj? - Sa fidanë të pemëve të ullirit janë mbjellur dhe në cilat zona konkretisht? Sa është vlera e investimit nga ana e buxhetit për llojin në fjalë. Sa fidanë të tjera janë mbjellë dhe çfarë subvencionesh janë dhënë? -Grantet për nxitjen e prodhimit në zonat kodrinore, malore, për mbjelljen e drurëve frutorë,		për informacion duhet të paraqitet në mënyrë më të strukturuar, duke u fokusuar në informacionet specifike dhe të qarta që janë më të lehta për t'u ofruar. Edhe pse, sipas ligjit për të drejtën e informimit nuk kërkohet motivi i paraqitjes së një kërkesë, kjo nuk duhet shkaktojë keqinterpretim apo abuzim të ligjit. Për të gjitha pyetjet që lidhen me vendimarrjen e politikave ndër vite ju ftojme të vizitoni faqen zyrtare të www.qbz.gov.al ku gjeni të përditësuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe faqen zyrtare www.bujqesia.gov.al për cdo njoftim dhe përditësim të informacionit, që sipas ligjit, bëhet publik, pa qenë nevoja e paraqitjes së një kërkesë. Sa më sipër, duke arsyetuar bazueshmërinë e kësaj kërkesë për informim, vlerësojmë se përveçse qëllim kurioziteti apo studimi, hulumtumi të mëtejshëm, kërkesa nuk realizon asnjë nga qëllimet për të cilat janë garantuar këto të drejta nga ligji apo nga standartet e ratifikuara evropiane. Kështu që, bazuar në pikën 5, të nenit 5 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentat zyrtare” ratifikuar me ligjin nr. 45/2022, kjo kërkesë konsiderohet haptazi e paarsyeshme.		
--	--	--	--	--	--

		rritjen e sipërfaqeve me serra diellore				
--	--	--	--	--	--	--

	dhe me ngrohje - Si është reformuar sistemi i certifikimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale? - Çfarë masash janë marrë për zhvillimin e akuakulturës? - A është reduktuar tatimi mbi vlerën e shtuar për farërat, fidanët, materialin gjenetik shtazor, plehërat kimike, pesticidet, vaksinat e blegtorisë? Kur ka nisur të aplikohet dhe në çfarë mase është reduktuar? -A është vendosur në funksion qendra e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së inputeve bujqësore? Në çfarë date?Kopje të rezultateve të raporteve nga këto kontrolle. - A është bërë ulja e TVSH-së në inputet bujqësore në kostot e fermerëve?Në cilin vit? Sa fermerë kanë përfituar? - Çfarë masash kontrolli janë marrë për qendrën e cilësisë dhe sigurisë së inputeve bujqësore? -Të dhënat mbi eksportet dhe importet e prodhimeve bujqësore për periudhën e kërkuar. - Të dhëna mbi parkun e mjeteve publike dhe private, për mirëmbajtjen e sistemit kullues dhe vaditës të vendit sipas periudhës së kërkuar. A ka pasur zgjerim të kapaciteteve? Kur ka ndodhur? Vlera e investimit dhe burimi. Të				
--	--	--	--	--	--

		dhëna mbi arifat e furnizimit me energji elektrike për sistemin				
--	--	---	--	--	--	--

		e kullimit dhe të vaditjes. - Rol i komunave në mirëadministrimin e burimeve ujore dhe rrjetit ujitës dhe kullues për periudhëne kërkuar. -Çfarë është bërë mbi regjistrimin e titujve të pronësisë publike dhe private mbi tokën bujqësore? Sa regjistrime janë kryer specifikisht për secilin vit? - Numri i vendeve të reja të punës të krijuar në agropërpunim, agroturizëm, gjueti, peshkim turistik specifikisht për secilin vit. Çfarë projektesh konkrete janë zbatuar për të mbështetur industrinë e përpunimit agroushqimor? A mund të jepni të dhëna për ndihmën e dhënë dhe efektin e saj në ndërmarrjet lokale? Çfarë nismash janë ndërmarrë për të lehtësuar aksesin në tregjet e reja ndërkombëtare për produktet bujqësore shqiptare? - A mund të jepni shembuj të investimeve të bëra për zgjerimin e zinxhirit të agropërpunimit? - A është i hapur eksporti për molusqet drejt vendeve të BE-së? Kur ka nisur aplikimi? - Të dhënat e financimit publik mbi mbështetjen e zhvillimit rural. - Të dhëna mbi numrin e qendrave të grumbullimit, ruajtjes dhe tregtise me shumicë të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale për				
--	--	---	--	--	--	--

		periudhën e sipërpërmendur, specifikisht sipas secilit vit. Çfarë përmirësimesh janë bërë në sistemin e statistikave bujqësore				
--	--	---	--	--	--	--

	për sa i përket saktësisë dhe disponueshmërisë së të dhënave? - Çfarë hapash janë ndërmarrë për zbatimin e skemave të sigurimit të prodhimeve nga dëmtimet natyrore të kulturave bujqësore dhe blegtorisë. Sigurimet dhe vlerat përkatëse për secilin vit. Cilio është burimi i fondeve të këtyre sigurimeve. -Kur ka ndodhur për ristrukturimi dhe fuqizimi i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural? Çfarë hapash konkretë janë ndërmarrë për ristrukturimin e saj?- Jeni të lutur të bashkangjisni rezultatet e efektivitetit të ristrukturimit. - A mund të jepni një përshkrim të detajuar të qasjes së integruar që po zbatohet nga "ferma në tryezë"?Kur ka nisur? Çfarë masash apo veprimesh janë marrë për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e ushqimit? Si përfshihen palët e interesuara në sektorët e bujqësisë dhe ushqimit në këtë qasje të integruar? - Cili është statusi aktual i sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të bagëtive?Sa bagëti janë regjistruar me sukses në këtë sistem? A ka ndonjë sfidë apo pengesë që kanë ndikuar në funksionimin e plotë të këtij sistemi? - Çfarë përmirësimesh specifike janë bërë në sistemet e identifikimit dhe raportimit për				
--	--	--	--	--	--

		sëmundjet infektive dhe parazitare në bimë dhe kafshë?Sa shpesh përditësohen këto sisteme dhe çfarë protokolle ekzistojnë për raportimin e sëmundjeve?A ka ndonjë bashkëpunim me organizata ndërkombëtare për kontrollin dhe gjurmimin e sëmundjeve? Nëse dispononi një raport mbi të dhënat e siguruara nga ky sistem mbi sëmundjet e indentifikuara nga nisja e funksionit deri në vitin 2024 (specifikisht për secilin vit) jeni të lutur ti bashkangjisni. - Çfarë masash janë marrë për të zgjeruar mbulimin e vaksinimit për bagëtinë?Sa kafshë janë vaksinuar në kuadër të programeve të zgjeruara deri më tani?Çfarë rezultatesh janë raportuar në lidhje me shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik që nga fillimi i nismës së vaksinimit? - Çfarë mekanizmash mbikëqyrës janë krijuar për tregjet e kafshëve?Sa shpesh inspektohen këto tregje dhe cilat janë rezultatet e këtyre inspektimeve? Çfarë masash kontrolli janë marrë për të monitoruar përpunimin dhe shpërndarjen e mishit në tregjet e brendshme? Sa shkelje janë gjetur dhe masat për secilën prej tyre. - Numri i ndërmarrjeve agropërpunuesenga viti 2005-2024(specifikisht për secilin vit) . Sa prej tyre kanë respektuar standardet e sigurisë për secilin				
--	--	--	--	--	--	--

		vit të kërkuar. Sa prej tyre kanë marrë mbështetje në zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore? Vlera e mbështetjes për këto ndërmarrje konkretisht sipas secilës ndërmarrje dhe secilit vit. - Çfarë hapash janë ndërmarrë për të përfunduar akreditimin ndërkombëtar të qendrave kombëtare të referencës në fushën e sigurisë ushqimore? - A ka përfunduar harta e rajonizimit të kulturave të ndryshme bujqësore dhe e racave të ndryshme? Nëse po, ku mund t'a gjejmë sot këtë informacion? Sa është financimi për këtë projekt hartografik? - Çfarë programesh specifike janë hartuar për të adresuar nevojat për specialistë të bujqësisë? Sa pjesëmarrës ka pasur? Si vlerësohet efektiviteti i këtyre programeve? A ka partneritete me institucionet arsimore apo palët e interesuara të industrisë për të rritur trajnimin? Vlera e këtyre projekteve dhe burii i financimit. - A mund të jepni shembuj të historive të suksesit që janë promovuar në bujqësi, blegtori dhe agropërpunim? Si po vlerësohet ndikimi i këtyre promovimeve? Cilat kanale po përdoren për të shpërndarë këto histori suksesi në një audiencë më			
--	--	---	--	--	--

		të gjerë? Vlera për këtë projekt dhe burimi i financimit. - Çfarë				
--	--	---	--	--	--	--

		metodologjie po përdoret për të kryer inventarizimin e plotë të projekteve bujqësore?Sa shpesh monitorohet zbatueshmëria e projekteve bujqësore?A janë të disponueshme publikisht gjetjet nga këto vlerësime? Kërkoj një kopje të këtyre vlerësimeve sipas projekteve. - Çfarë mbështetje është dhënë për rinovimin e flotës dhe pajisjeve të peshkimit? Si ka ndikuar ky rinovim në furnizimin me lëndë të parë për fabrikat e përpunimit? Bashkangjisni të dhëna specifike në lidhje me modernizimin e flotës. -Sa markata peshku ka sot në vendin tone? Ku janë të vendosura? Kur ka nisur ndërtimi dhe përfundimi i tyre? Sa prej tyre janë në funksion? Vlera dhe burimet financimit për ndërtimin e secilës prej tyre. Çfarë nismash konkrete po zbatohen për zhvillimin e akuakulturës? - Cili është ndikimi i pritshëm në ekonominë lokale dhe krijimin e vendeve të punës nga këto nisma? - Çfarë politikash nxitëse janë krijuar për të promovuar turizmin rural, veçanërisht për emigrantët dhe gratë? Si matet efektiviteti i këtyre mbështetjeve? - A ka programe ekzistuese të dedikuara për trajnimin dhe mbështetjen e bizneseve të agroturizmit? -Të			
--	--	--	--	--	--

		dhëna mbi sistemin e statistikave bujqësore, si funksionon? Si është zhvilluar në vite? Kostot për				
--	--	--	--	--	--	--

		zhvillimine këtij sistemi dhe burimin e financimit. - Sa ka qenë dhe është Tatim fitimi për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor për periudhën e sipërpërmendur. -Sa ka qenë dhe është TVSH për makinat bujqësore (si në import ashtu dhe brenda vendit) 27 zëra doganorë të peshkimit, rrjetat, anijet, pajisjet elektronike, frigoriferët, motorët e anijeve etj. në bordin e anijeve të peshkimit, të trajtuara si furnizime bordi për periudhën e sipërpërmendur. - Tarifa për regjistrimin dhe vaksinimin e detyruar të blegtorisë viti 2005 deri në vitin 2024 (specifikisht për secilin vit)				
19.	27.2.2025	Pasi tre ngarkesat me <u>mandarina</u> me origjinë nga Shqipëria u kthyen mbrapsht nga Kroacia, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Berat doli në një deklaratë duke bërë me dije se u gjobit subjekti eksportues me pronar AD me 4 milion lekë, por nuk u diskutua lidhur me tregtimin e agrumeve. -Gjatë gjithë këtij procesi, ju si Ministri e linjës, keni marrë masa? -A e keni kontrolluar ju AKU në kryerjen e detyrës dhe asgjесimin e produkteve që janë të dëshmuar për konsumatorin shqiptar dhe jo vetëm?	20.3.2025	 pergjigje.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		- A keni në plan që të ndërmerri masa ndaj AKU që nuk ka vepruar për të kryer detyrën? - A keni bërë ju si ministri e linjës, kontrole në terren për t'u siguruar që fermerët (ata që prodhojnë për tregoun vendas, por dhe ata që eksportojnë) respektojnë rregullat e caktuara nga Bashkimi European dhe të gjitha autoritetet e tjera? - Nëse po, si? - A e keni marrë parasysh që fermerët mund të mos jenë të informuar lidhur me pesticidet që ndalohen nga Bashkimi European?				
20.	10.3.2025	Na vini në dispozicion sipërfaqet e mbjella me pambuk në Shqipëri në 5 vitet e fundit si dhe fermat bashkëlidhur.	20.3.2025	Pas koordinimit të kësaj kërkesë edhe me institucionet e varësisë, bazuar në të dhënat administrative tëështë dhënë e prodhimit bujqësor dhe blegtoral të mbledhura nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, rezulton se kultura e pambukut nuk kultivohet në vendin tonë.	Përgjigja i plotë.	0

21.	10.3.2025	Sa pula ngordhën nga gripi i shpendëve? Cili është subjekti që asgjësoi pulat e ngordhura të pularisë Reas? Cfarë metode asgjësimi u përdor nga ky subjekt?	1.4.2025	Prej datës 2.3.2025 deri më datë 21.3.2025, në subjektet e identifikuar me praninë e sëmundjes së Gripit të shpendëve (Influenca Aviare) në total ka pasur 426.157 krerë të ngordhur. Në zbatim të nenit 79, pika 2 të ligjit nr. 10 465/2011 “Për shërbimin veterinar”, të ndryshuar, subjekti është i detyruar të ndjekë procedurat e asgjëimit. Në rastin konkret, subjekti i cili është identifikuar me praninë e Sëmundjes së Gripit të Shpendëve ka përzgjedhur për asgjësimin e shpendëve, shoqërinë "X" sh.p.k dhe shoqërinë "Y" sh.p.k. Metoda e përdorur për asgjësimin e shpendëve është një nga metodat e zgjedhura bazuar në Urdhrin Nr. 411, datë 20.09.2022 "Për miratimin e Planit të Kontigjencës	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
-----	-----------	--	----------	---	----------------------------------	---

				për Sëmundjen e Gripit të Shpendëve (Influenca Aviare)", të ndryshuar		
22.	11.3.2025	- Sa projekte zhvillimore ka ndërmarrë Ministria e Bujqësisë në kuadër të programit “100 fshatrat”? Sa është vlera e investimit? Ju lutem na vini në dispozicion listën e projekteve që ka përfutur secili prej tyre dhe llojin e ndërhyrjes së përfutur... - Deri kur parashikohet të zgjasë projekti 100 fshatrat? A keni një model zhvillimi për të ardhmen e këtyre fshatrave?	18.3.2025	Bazuar në pikën 2 të nenit 9 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, informacioni që ju kerkoni është u është përcjelle me pare në datën 8.1.2025 në adresën e.k....@gmail.com	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

23.	17.3.2025	1- Sa ferma ne Republikën e Shqipërisë janë evidentuar me gripin e shpendëve? 2- Pas evidentimit, sa lloje produktesh janë tërhequr nga tregu? 3- Cfarë masash po ndërmerr Ministria dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve?	1.4.2025	Nga momenti i konstatimit të shfaqjes së gripit të shpendëve e deri më tani, janë evidentuar tre ferma të prekura nga gripi i shpendëve (Influenca Aviare). Këto ferma ndodhen në qarkun e Durrësit: dy prej tyre në fshatin Maliq Muco, Njësia Administrative Rashbull, dhe një në fshatin Kullë, Njësia Administrative Sukth. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në kuader të garantimit të sigurisë ushqimore në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, si dhe bazuar në njoftimin e menjehershëm të ardhur nga ISUV, për konfirmimin e sëmundjes së Influenca Aviare, si dhe njoftimeve zyrtare të marra nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Durrës, ka bllokuar të gjithë sasinë e produktit vezë të konstatuar gjëndje në keto subjekte. Gjithashtu, në shkallë vendi, AKU mori masa për monitorimin dhe kontrollin në treg, lidhur me gjurmueshmerinë e produkteve me origjinë shtazore për konsum human. Konkretisht për subjektin REA's janë tërhequr nga tregu 6 758 kokrra vezë sipas gjurmueshmerisë të deklaruar nga subjekti dhe për subjektin AIBA janë tregu 36 000 kokrra vezë. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është në proces monitorimi në të gjitha operatorët e biznesit ushqimor	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
-----	-----------	---	----------	--	----------------------------------	---

				të cilët tregtojnë produktin vezë apo e përdorin në prodhim për ti garantuar konsumatorit produkt të sigurt. Pas konfirmimit të rasteve pozitive me Influncën Aviare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) ka njoftuar të gjitha strukturat përkatëse dhe ka marrë masat e nevojshme në përputhje me Planin e Kontingjencës nr. 411, datë 20.09.2022, "Për miratimin e Planit të Kontingjencës për sëmundjen e gripit të shpendëve (Influenca Aviare)". Për rastin konkret AKVMB ka kryer: ○ Vendosjen e zonës së prekur në karantinë. ○ Inventarizimin e fermës dhe fermave përreth vatrave. ○ Vendosjen e një zone të mbrojtur (3 km rreze) dhe zonës së mbikëqyrur (10 km rreze). ○ Eliminimin e shpendëve të prekur dhe dezinfektimin e kapanoneve dhe pajisjeve që kanë qenë në kontakt me ta. ○ Informimin e fermerëve dhe strukturave të tjera përkatëse mbi situatën dhe masat parandaluese.		
24.	17.3.2025	kërkoj informacion mbi mbështetjen financiare dhe subvencionet e akorduara për fermerët gjatë vitit 2023 dhe tremujorit të parë të vitit 2024. Në mënyrë specifike, kërkoj: 1. Listën e skemave të subvencionimit të ofruara nga Ministria gjatë kësaj periudhe. 2. Kriteret dhe procedurat përpërfitimin e këtyre subvencioneve. 3. Shumat totale të akorduara për fermerët dhe	1.4.2025	 Pergjigje.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		shpërndarjen e tyre sipas rajoneve.				
--	--	-------------------------------------	--	--	--	--

		4. Çdo plan të ardhshëm për rritjen ose ndryshimin e skemave të subvencionimit.				
--	--	---	--	--	--	--

25.	26.3.2025	1. A keni ofruar mbeshetje financiare per organizatat jofitimprurese gjate vitit 2024? 2. Nese keni ofruar mbeshetje financiare, cila ka qene forma e mbeshetjes (grant, kontrata sherbimi, prokurim publik/tenderim) 3. Sa OJF kane aplikuar permbeshetje financiare gjate vitit 2024? Ju lutem specifikoni sipas formes se mbeshetjes, nese ka patur me shume se nje forme. 4. Sa OJF kane perfituar nga kjombeshetje? Ju lutem specifikoni sipas formes se mbeshetjes, nese ka patur me shume se nje forme 5. Cili ka qene buxheti i disbursuar per organizate dhe ne total? Ju lutem specifikoni sipas formes se mbeshetjes, nese ka patur me shume se nje forme 6. Keni ofruar mbeshetje jofinanciare gjate vitit 2024? Cila eshte baza ligjore qe rregullon kete forme mbeshetjeje? 7. Nese keni ofruar mbeshetje financiare, sa OJF kane perfituar nga kjo mbeshetje? Cili ka qene lloji i mbeshetjes jofinanciare te ofruar (mjedisa, trajnime, ndarje eksperiencash etj.) 8. Sa eshte numri i konsultimeve publike te realizuara gjate vitit	10.4.2025	 pergjigje.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
-----	-----------	--	-----------	---	----------------------------------	---

		2024? 9. A ka institucioni juaj koordinator per njoftimin dhe konsultimin publik? Nese po, ju lutem citon emrin dhe kontaktin. 10. A ka institucioni juaj koordinator per shoqerine civile? Nese po, ju lutem citoni kontaktin. 11. Sa OJF kane marre pjese ne konsultime publike te organizuara nga institucioni juaj? 12. Sa perqind % e ligjeve dheakteve nenligjore te hartuara nga institucioni juaj jane si rezultat i konsultimeve me OJF-te? 13. A jane te perfshire anetare te OJF-ve ne organe keshillimore te institucionit tuaj?Nese po, cilat jane keto organe keshillimore dhe sa OJF jane perfshire ne to? 14. A jane perfshire OJF ne grupet e punes te ngritura ne institucionin tuaj? Nese po, cilat jane keto grupe puna dhe sa OJF jane perfshire ne to?				
--	--	---	--	--	--	--

26.	26.3.2025	1.Çfarë masash po merren për të garantuar sigurinë ushqimore dhe cilësinë e produkteve bujqësore? 2.Si po ndihmon ministria në promovimin e produkteve vendase dhe zgjerimin e tregjeve të eksportit? 3.Çfarë strategjish ka ministria për të përmirësuar infrastrukturën rurale dhe për të reduktuar braktisjen e fashtrave?	10.4.2025	 Kthim pergjigje.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
27.	28.3.2025	Lutem kërkojmë mbështetjen Tuaj lidhur me dërgimin e një kopje të urdhrin të ministrit numër 185 datë 25.02.2025 “Për përdorimin dhe shpërndarjen të programit buxhetor, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit për vitin 2025” për efekte studimore.	10.4.2025	 kthim pergjigje.docx	Refuzuar	0
28.	28.3.2025	1-Na vendosni në dispozicion numrin e fermave të regjistruara në Shqipëri. 2-Na vendosni në dispozicion numrin e krerëve në Shqipëri. 3-Na vendosni në dispozicion masat e marra për subvencionimin e fermerëve. Ju lutem, na e bashkangjisni ne email dokumentin. 4-Cilat janë kriteret për përfitimin e granteve dhe subvensioneve në sektorin e blegtorisë?	10.4.2025	Per pyetjen 1 dhe 2 lutem referoni tabelen bashkelidhur.  Worksheet in.xlsx Në përgjigje të pyetjes suaj ju lutem gjeni bashkëngjitur Vendimin Nr.150, datë 06.03.2025 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2025”. Linku i materialit: http://qbz.gov.al/eli/vendim/2025/03/06/150	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

			Kriteret për përfitimin e granteve dhe subvensioneve në sektorin e blegtorisë janë të përcaktuara në udhëzimin “Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për masat mbështetëse për vitin 2025” i cili është aktualisht në procedurë miratimi. Pas miratimit, ky dokument do të botohet në Fletore Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR).		
--	--	--	--	--	--

29.	2.4.2025	1. Masat institucionale për transhumancën Pas përfshirjes së transhumancës shqiptare në listën e trashëgimisë kulturore jomateriale të mbrojtur nga UNESCO, a ka ndërmarrë institucioni juaj ndonjë politikë, strategji apo veprim konkret për mbështetjen dhe ruajtjen e kësaj praktike si pjesë e bujqësisë ekstensive? 2. Numri i veterinerëve. Sa është numri aktual i veterinerëve të punësuar në strukturat shtetërore, konkretisht në Drejtoritë Rajonale të Veterinarisë në Shqipëri? 3. Të dhëna mbi barinjtë dhe bagëtinë: Ju lutem të na vini në	16.4.2025	<table><tr><td></td><td></td><td colspan="2">Numri i krerëve</td><td rowspan="4">së Bimëve është 530.</td></tr><tr><td>Nr</td><td>Përshkrimi</td><td>2022</td><td>2023</td></tr><tr><td>1</td><td>Të leshta</td><td>1,371,700</td><td>1,206,206</td></tr><tr><td>Nga të cilat</td><td>Dele</td><td>1,085,300</td><td>1,006,328</td></tr><tr><td>2</td><td>Të dhirta</td><td>721,600</td><td>640,242</td><td></td></tr><tr><td>Nga të cilat</td><td>Dhi</td><td>562,800</td><td>511,950</td><td></td></tr></table> Burimi: INSTAT/MB ZHR			Numri i krerëve		së Bimëve është 530.	Nr	Përshkrimi	2022	2023	1	Të leshta	1,371,700	1,206,206	Nga të cilat	Dele	1,085,300	1,006,328	2	Të dhirta	721,600	640,242		Nga të cilat	Dhi	562,800	511,950		Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
		Numri i krerëve		së Bimëve është 530.																													
Nr	Përshkrimi	2022	2023																														
1	Të leshta	1,371,700	1,206,206																														
Nga të cilat	Dele	1,085,300	1,006,328																														
2	Të dhirta	721,600	640,242																														
Nga të cilat	Dhi	562,800	511,950																														

	dispozicion të dhëna statistikore për vitet 2022, 2023 dhe 2024 4. Monitorimi i shëndetit të bagëtive gjatë transhumancës Cili është mekanizmi i monitorimit të shëndetit të bagëtive gjatë periudhës së verës në kullotat malore? 5. A ekziston një protokoll i përcaktuar për këtë proces dhe cilat janë institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij?	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit I takimeve dhe komunikimeve me aktorët e dhe shqyrtimit të sugjerimeve, bazuar në t marra nga përfaqësuesit e Ministrisë së Tu Mjedisit si dhe nga Autoriteti Kombëtar i V dhe Mbrojtjes së Bimëve, ka ndërmarrë nis hartuar një plan strategjik veprimi "Jet shtegtuese perspektivat e zhvillimit në Shc plan veprimi është ende në proces përfu miratimi. Gjithashtu, MBZHR përmes Proje Rrugët e Gjelbra për Blegtorinë Shqiptare, të tjerave, kishte edhe dy objektivat e mëp mbështetur dhe ngritur modelin në vijim: 1. Të forcojë reziliencën/elasticitetin/qëndrue e modeleve pastorale duke u mbështetur në Progresit; • Ftohje e qumështit me energji diellore në fe kullotë (Ftohja e bidonave). Stani i bariut Çajup të Gjirokastrës (me tufë delesh), është	1.	
--	--	--	----	--

			ftohës bidonash individual me energji diellore si një element inovacioni teknologjik që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së qumështit dhe punën e përbashkët të barinjve që shfrytëzojnë atë kullotë. •Realizuar Trajnimi i blegtorëve dhe fermerëve përkatës për prodhimin e djathit të presuar tip Tomme për të realizuar bashkëpunimin e barinjve rreth një produkti të origjinës së kontrolluar. Nga ana e projektit është prodhuar në Francë një stampe unike identifikuese ushqimore, e shëndetshme, dhe e pakopjueshme ose falsifikueshme, që është integruar në sipërfaqen e djathit të prodhuar si produkt me origjinë të kontrolluar në fshatin Shtyllë dhe në Çajup të Gjirokastrës. •Gjithashtu mjediset e kësaj ferme kanë qenë mbështetur dhe kanë përfituar edhe për instalimin e paneleve diellore në mjediset dhe strehimet ndihmëse në Fush-Çajup. 2. Të shoqërojë procesin e njohjes së Shtegtimin në Trashëgiminë Kulturore jo - materiale të njerëzimit (UNESCO). Bazuar në të dhënat e përcjella nga Drejtoritë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, rezulton se në vendin tonë shtegtojnë drejt kullotave (verore dhe ose dimërore) rreth 400 ferma (kryesisht) me bagëti të imëta, të cilat përbëjnë rreth 7% të numrit total të fermave me blegtori të imët që mbarështojnë jo më pak se 100 krerë/fermë. Këto 400 ferma mbarështojnë rreth 97 mijë krerë të imëta (dele dhe ose dhi) në total, të cilat zotërojnë rreth 6% të të gjithë krerëve që zotërojnë tufat me jo më pak se 100 krerë bagëti të imëta në të gjithë vendin. 4. Bazuar në nenet 19,20, 20/1, 21, 22 të Ligjit Nr. 10465, datë 29.9.2021 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar janë të përcaktuara qartë mekanizmat e monitorimit dhe raportimit në rast dyshimi apo konfirmimi të sëmundjeve nga të gjithë aktorët e përfshirë.		
--	--	--	--	--	--

				Gjithashtu, bazuar në ligjin e sipërcituar janë miratuar me Urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit		
--	--	--	--	---	--	--

				Rural programet e kontrollit të sëmundjeve, përkatësisht për kafshët të cilat kryejnë procesin e transhumancës janë si më poshtë vijon: - Urdhri Nr. 26, datë 10.1.2025 “Për një ndryshim në Urdhrin Nr. 176, datë 28.3.2023 “Për miratimin e Programit të Kontrollit të Sëmundjes së Plasjes”, i ndryshuar, i cili parashikon vaksinimin e të gjitha tufave të kafsheve në vatrën e rezultuara pozitive me sëmundjen e plasjes 3 vitet e fundit dhe përcakton qartë të gjitha detyrat e aktoreve të pershire për menaxhimin dhe monitorimin e situatës në raste dyshimi apo konfirmimi të sëmundjes së plasjes.- Urdhri Nr. 233, datë 07.03.2025 “Për miratimin e Programit të Kontrollit të Brucelozës në të Imta”, i cili parashikon vaksinimin e të gjitha kafshëve të remontit dhe përcakton qartë të gjitha detyrat e aktorëve të pershire për menaxhimin dhe monitorimin e situatës në raste dyshimi apo konfirmimi të sëmundjes së brucelozës në të imta.- Urdhrin Nr. 1091, datë 18.12.2024 “Për miratimin e Programit të Kontrollit të Sëmundjes së Brucelozës në Gjedh”, i cili parashikon gjurmimin e sëmundjes së brucelozës në gjedh në të gjitha fermave me 3 krerë e lart dhe përcakton qartë të gjitha detyrat e aktorëve të pershire për menaxhimin dhe monitorimin e situatës në raste dyshimi apo konfirmimi të sëmundjes. Programet e sipërcituara janë konform legjislacionit të BE-së dhe kanë si qëllim monitorimin dhe kontrollin e shëndetit të kafshëve. Gjithashtu, mekanizmi i monitorimit të shëndetit të kafshëve kryhet konform udhëzuesit për sëmundjet infektive. 5. Procesi i transhumancës monitorohet nga veterinerët zyrtar të shërbimit veterinar në varësi të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të cilët kryejnë kontrollin shëndetësor të kafshëve dhe lëshojnë certifikatat veterinare të lëvizjes së tyre. Certifikata veterinare e lëvizjes së kafshëve përcakton qartë vendin e origjinës dhe destinacionin e lëvizjes së tyre. Gjithashtu, institucione të tjera të përfshira janë Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, për	
--	--	--	--	---	--

				testimin dhe konfirmimin ose jo të prezencës së sëmundjeve dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore, të cilat përcaktojnë kullotat.		
30.	8.4.2025	1. Plani i kontrollit dhe/apo monitorimit të aflatoksinave në qumësht dhe nënprodukte të tij, të zbatuara nga autoritetet përgjegjëse në varësi të Ministrisë Bujqësive dhe Zhvillimit Rural për periudhën Janar 2024 deri në Prill 2025 është përkatesisht 26 mostra. 2. Rezultatet analitike të këtyre kampioneve, përfshirë numrin e mostrave që kanë rezultuar jashtë normave të lejuara për përmbajtjen e aflatoksinave. 3- Çfarë masash konkrete ka marrë AKU në ndjekje të kësaj problematike	15.4.2025	Kthyer nga AKU	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

31.	9.4.2025	1. Kopje te cdo akti zyrtar qe MBZHR disponon lidhur me veprimtarine e kesaj qendre e cila theksojme se ushtron veprimtarine ne toke bujqesore ngjitur me pronat e banoreve te tjere qe I perdorin keto toka per kultivimin e bimeve si dhe ngjitur me shtepite e banimit ne fshatin Bultice I cili ndodhet vetem 10 km larg nga Tirana. 2.Kopje te akteve te kontrollit te ushtruar nga MBZHR prane kesaj qendre sa i takon plotesimit te kriterave per te mbajtur te	24.4.2025	Deleguar AKVMB	Deleguar AKVMB	0
-----	----------	--	-----------	----------------	----------------	---

		ushqyer, vaksinuar dhe regjistruar kafshet e semura. 3.Kopje te akteve te kontrollit sa i takon zbatimit te nenit 78 te ligjit nr. 10465/2011 “Per sherbimin veterinar” 4. Kerkojme te informohemi nese MBZHR ka dhene apo ka dijeni nese per kete qender eshte dhene autorizim/leje/license per krijimin e varrezave dhe varrosjen e kafsheve te ngordhura.				
--	--	---	--	--	--	--

32.	14.4.2025	1-Cilat janë procedurat standarde të kontrollit që AKU ndjek për të garantuar sigurinë e produkteve ushqimore në treg, në veçanti të mishit dhe produkteve të shpendëve? 2-Sa shpesh kryhen kontrollet për produktet me rrezikshmëri të lartë për kontaminim si mishi i pulës dhe çfarë metodash laboratorike përdoren? 3-Në rast të zbulimit të një kontaminimi me agjentë patogjenë (si salmonela), cilat janë hapat e menjëhershëm dhe masat administrative që merren për të mbrojtur shëndetin publik?	15.4.2025	Deleguar AKU	Deleguar AKU	0
33.	10.4.2025	Bazuar në përmbajtjen e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të vitit 2016 (ratifikuar me Ligjin Nr. 4/2016) dhe Marrëveshjes së ndryshuar dhe rivendosur të vitit 2020 (ratifikuar me Ligjin Nr. 39/2021), MBZHR disponon	25.4.2025	 Informacion mbi marrëveshjen me BER	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		informacionin e parashikuar në tekstet përkatëse të këtyre marrëveshjeve, si më poshtë: 1. Sa është fondi i disbursuar në ndihmë të agrobiznesit? 2. Sa është shuma e fondeve të dhëna në formën e bashkëpunimit dhe ndarja e tyre në këste? 3. Sa është tarifa e administrimit që i është paguar nga Qeveria shqiptare Bankës Europiane për fondet e dhëna për bashkëpunimin në këtë marrëveshje? 4. Sa është numri dhe emri i përfituesve të fondeve të dhëna për mbështetjen me kredi të agrobiznesit? 5. A kanë performuar mirë këto kredi dhe nëse jo, sa është numri i subjekteve që nuk kanë performuar dhe sa është shuma e paguar si rezultat i kësaj marrëveshje që ka mbështetur si garanci këto kredi? 6. Sa është tarifa e disbursimit të kredisë që është paguar nga Qeveria shqiptare ose bizneset? 7. Cilat janë bankat që janë bërë pjesë e kësaj marrëveshje për të mbështetur agrobiznesin me financing/riskedulim sipas termave të kësaj kontrate?				
34.	15.4.2025	1-Çfarë masash janë marrë për eliminimin e mishit të kontaminuar me salmonelë?	25.4.2025	 Kthim Pergjigje.doc	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		2-Pse është publikuar me vonesë lajmi për tregtimin e mishit me salmonelë? 3-Si po monitorohet parandalimi i tregtimi të frutave dhe perimeve të stinës me ngarkesë mbi normë me pesticide?				
35.	14.5.2025	Po ju drejtohem për të kërkuar informacion lidhur me procedurat dhe mundësitë për blerjen e tokave në zonat malore, me qëllim zhvillimin e projekteve rurale. Nga sa kam kuptuar, një ligj i ri lidhur me këtë çështje është miratuar së fundmi, dhe do të doja të dija më shumë rreth mënyrës se si mund të nis procedura, cilat janë kriteret, dhe ku mund të drejtohem për dokumentacionin e nevojshëm. Nëse ka ndonjë zyrë specifike apo kontakt tjetër për këtë çështje, do të isha mirënjohës nëse mund të ma përcillni.	22.5.2025	Me poshte do te gjeni linkun perkates te QBZ ku gjendet i publikuar informacioni qe kerkoni. http://qbz.gov.al/eli/ligj/2025/03/13/20 Megjithate ju bejme me dije se nisma per hartimin e ligjit ne zonat malore eshte ndermarre nga Ministria Ekonomise, Kultures dhe Inovacionit, ndaj per informacion me te detajuar ne vijim, ju sugjerojme t'i drejtoheni ketij institucioni.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
36.	26.5.2025	1-Na vendosni në dispozicion një kopje të deklaratës së nënshkruar në tetor të vitit 2024,mes Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe homologut turk Ibrahim Yumakli mbi “Bashkëpunimin në fushën e sigurimeve në bujqësi”. 2-Deri ku ka shkuar zbatimi i këtij bashkëpunimi për sjelljen e modelit të ri të sigurimeve për bujqësinë?		  Mbi zbatimin e AL Deklarata e Deklarates se SynimiSynimit me Turqine (	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

37.	27.5.2025	1-Na vendosni në dispozicion rastet e raportuara nga pushtetet vendore drejt jush për fermerët të cilëve u janë dëmtuar të mbjellat nga breshëri 10 vitet e fundit. 2-Na vendosni në dispozicion të dhënat mbi vendet, numrin e fermerëve dhe hapsirën e tokave të prekura nga breshëri 10 vitet e fundit. 3-Na vendosni në dispozicion masat e marra prej jush për fermerët e dëmtuar 4-Si do ti parandaloni këto dëmtime në vitet e ardhshme?	12.6.2025	1-Na vendosni në dispozicion rastet e raportuara nga pushtetet vendore drejt jush për fermerët të cilëve u janë dëmtuar të mbjellat nga breshëri 10 vitet e fundit. Në zbatim të ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, e drejta për kompensim financiar në rastet e fatkeqësive natyrore është e përcaktuar në: · germa gj), neni 30; · nenin 41, i cili rregullon të drejtën e kompensimit; si dhe · nenin 65, ku përcaktohet se buxheti i bashkive përmban fonde për mbrojtjen civile dhe menaxhimin e pasojave të fatkeqësive. Për zbatimin e këtyre dispozitave janë në fuqi edhe aktet nënligjore: · VKM nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; · VKM nr. 414, datë 8.7.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”. Në përputhje me kuadrin ligjor të sipërcituar, kompetenca për vlerësimin dhe propozimin për ndihmë financiare në raste të tilla i përket njësisë të qeverisjes vendore. Pas vlerësimit dhe dokumentimit të dëmeve nga strukturat vendore dhe përgatitjes së kërkesës për financim nga fondi i mbrojtjes civile, bashkia mund të paraqesë kërkesë zyrtare për mbështetje pranë autoriteteve qendrore, në përputhje me procedurat e përcaktuara në VKM-të përkatëse. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është në pamundësi ligjore për të ndërhyrë financiarisht në mënyrë të drejtpërdrejtë në këto raste. 2-Na vendosni në dispozicion të dhënat mbi vendet, numrin e fermerëve dhe hapsirën e tokave të prekura nga breshëri 10 vitet e fundit. Të dhënat disponohen nga Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor në parashikimin e prodhimit bujqësor. 3-Na vendosni në dispozicion masat e marra prej jush për fermerët e dëmtuar.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
-----	-----------	---	-----------	---	----------------------------------	---

				Lidhur me fermerët e dëmtuar janë ndërmarrë një sërë masash në drejtim të adresimit të problemit dhe dhënies së këshillimit për vazhdimësinë. Po ashtu janë orientuar fermerët drej aplikimeve në skemat kombëtare të mbështetjes, si dhe sigurimin e prodhimit bujqësor. 4-Si do ti parandaloni këto dëmtime në vitet e ardhshme? MBZHR, në kushtet aktuale që po kalojmë si efekt i ndryshimeve klimatike ka ndërmarrë një sërë masash lidhur me: - Financimin për infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit dhe mbrojtjen nga përmytja; - Financimin përmes investimeve në fermë të rrjetave antibreshër; - Këshillimin nga strukturat e ekstensionit. Lidhur me sigurimet në bujqësi, është ngritur grupi i punës dhe po punohet për një skemë të re, duke konsideruar dhe modelet eskzistuese të vendeve të tjera.		
38	5.6.2025	1. Sa është numri i licencave i dhënë deri më tani për kultivimin e kanabisit mjekësor dhe industrial? Sa është sipërfaqja e dhënë deri më tani? 2. Sa është hapësira e planifikuar të jepet për kultivimin e kanabisit mjekësor dhe industrial? 3. Ka një vendim të Qeverisë për 10 zona kadastrale në vend që parashikohet kultivimi i kanabisit, pse PD flet për 138 zonat kadastrale?	13.6.2025	1. Në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 61/2023 pranë Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it ngrihet Komisioni i Licencave, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të paraqitura për marrjen e licencës, për kultivimin e cannabis-it për qëllime mjekësore. Ky komision përbëhet nga 7 anëtarë ku 2 përfaqësues janë nga MBZHR. Që nga ngritja e këtij Komisioni, nuk është lëshuar ende asnjë licencë për kultivimin e cannabis-it. Megjithatë, nëse në vijim do të keni interes për informacion shtesë lidhur me numrin e aplikimeve të paraqitura, procesin e vlerësimit apo licencat e lëshuara, ju sugjerojmë që t'i drejtoheni drejtpërdrejt Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it. Kjo pasi Komisioni i Licencave për cannabis për qëllime mjekësore ngrihet dhe funksionon pranë këtij institucioni. Gjithashtu edhe për aplikimin për licencim për cannabis për qëllime industriale nuk ka patur asnjë licencë. 2. Në lidhje me pyetjen tuaj ju bëjmë me dije se nuk ka një hapësirë të planifikuar për kultivim cannabis por zona	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

				kadastrale janë miratuar me vendimin nr 149/2025. Miratimi i zonave kadastrale për kultivimin e bimës së kanabisit nuk nënkupton që e gjithë sipërfaqja e këtyre zonave do të mbillet me kanabis. Vetëm personat fizikë ose juridikë që përmbushin kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 61/2023 dhe aktet nënligjore përkatëse, do të kenë të drejtën të aplikojnë për licencë dhe të kultivojnë kanabis për qëllime industriale. Pra, jo çdo sipërfaqe brenda zonës së miratuar do të përdoret për kultivim, por vetëm ato parcela që plotësojnë standardet dhe për të cilat është dhënë leje nga autoritetet përkatëse. 3. Me vendimin Nr. 149, date 6.3.2025 të Këshillit të Ministrave janë miratuar zonat kadastrale në të cilat lejohet kultivimi i bimës së cannabis-it për qëllime industriale. Më poshtë link ku mund të aksesoni dhe zonat përkatëse http://qbz.gov.al/eli/vendim/2025/03/06/149		
39.	3.7.2025	1. Cilat janë arsyet konkrete dhe të dokumentuara që justifikojnë pezullimin e plotë të punës së AKU? 2. A është bërë një analizë zyrtare nga Ministria e Bujqësisë mbi dështimet apo problematikat e AKU-së përpara marrjes së këtij vendimi ekstrem? 3. Çfarë mekanizmash do të garantojnë sigurinë ushqimore gjatë periudhës që AKU do të jetë e pezulluar? Kush do të kontrollojë cilësinë dhe sigurinë e produkteve	14.7.2025	Në kuadër të reformës së përgjithshme të inspektoratit në Republikën e Shqipërisë, është miratuar Ligji nr. 99/2024 për Inspektimet, i cili përcakton kuadrin ligjor dhe organizativ për ushtrimin e detyrave inspektuese në nivel kombëtar. Aktualisht, po vijon procesi i hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore që do të shërbejnë si bazë ligjore për zbatimin efektiv të këtij ligji. Në lidhje me institucionet nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), reforma prek drejtpërdrejt Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU), Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA), si dhe Agjencinë Kombëtare të Veterinarisë dhe të Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB). Të treja këto institucione do të ristrukturohen në kuadër të procesit të reformës, duke i kaluar të gjitha funksionet dhe kompetencat e inspektoratit në një strukturë të vetme qendrore të inspektoratit. Aktualisht, nuk ekziston një pezullim i përgjithshëm i punës së AKU-së, por është vendosur pezullim i inspektimeve të paplanifikuara, në pritje të ristrukturimeve dhe përshtatjeve të	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		në treg? 4. Sa kohë parashikohet të zgjasë pezullimi total i AKU-së dhe çfarë ndodh me inspektorët ekzistues në këtë periudhë? 5. Si do të përzgjidhet komisioni i posaçëm që do të bëjë vlerësimin e burimeve njerëzore të AKU dhe cili do të jetë roli konkret i Universitetit Bujqësor të Tiranës në këtë proces? 6. Duke qenë se sipas ligjit në fuqi pezullimi i plotë i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit nuk mund të bëhet me urdhër të Ministrisë së Bujqësisë, mbi çfarë baze ligjore do të mbështetet ministria për ta realizuar këtë pezullim total?	nevojshme sipas ligjit të ri. Inspektimet e planifikuara dhe të miratuara nga titullari i AKU-së po kryhen në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me planet operationale të miratuara. Vendimi për pezullimin e inspektimeve të paplanifikuara është marrë duke marrë parasysh rritjen e ndjeshme të ankesave nga subjekte të ndryshme për qasjen dhe sjelljen e inspektorëve, mungesën e planeve operationale të argumentuara si dhe përgatitjet e nevojshme për implementimin e Ligjit nr. 99/2024. Në këtë kontekst, po punohet për adresimin e praktikave të mundshme abuzive gjatë ushtrimit të detyrave inspektuese, si dhe për rishikimin e mekanizmave të koordinimit midis strukturave rajonale dhe qendrore të AKU-së, me qëllim zbatimin e standarteve të unifikuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Njëherësh, prioritet i reformës mbetet garantimi i transparencës dhe përmbushja e standardeve ligjore dhe kërkesave të subjekteve të veprimtarisë së AKU-së. Për të siguruar një proces të drejtë dhe të efektshëm, është ngritur një grup pune për vlerësimin e performancës së drejtuesve dhe inspektorëve të AKU-së. Ky grup pune do të përfshijë ekspertizën e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), që do të sigurojë vlerësim profesional dhe të pavarur. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është në proces të hartimit të një plani pune të detajuar për vijimin e procedurave dhe marrjen e vendimeve të mëtejshme në funksion të realizimit të reformës së inspektoratit.			
40.	8.7.2025	1- Cilat janë hapat që do të ndërmerren nga Ministria e Bujqësisë për të shkruar AKU-në, kërkesë e bërë nga kryeministri Edi Rama? 2- A mund të kryej kontrole AKU derisa të shkrihet? 3- Kush do merret me kontrollet pasi të shkrihet AKU?	15.7.2025	Në kuadër të reformës së përgjithshme të inspektoratit në Republikën e Shqipërisë, është miratuar Ligji nr. 99/2024 për Inspektimet, i cili përcakton kuadrin ligjor dhe organizativ për ushtrimin e detyrave inspektuese në nivel kombëtar. Aktualisht, po vijon procesi i hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore që do të shërbejnë si bazë ligjore për zbatimin efektiv të këtij ligji. Në lidhje me institucionet nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), reforma prek drejtpërdrejt Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU), Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

		4- Në kuadër e të reformës së inspektorateve, si do të funksionojë kontrolli i sigurisë ushqimore? Nën cilin inspektorat qendror do të jetë edhe ky funksion?	(DSHPA), si dhe Agjencinë Kombëtare të Veterinarisë dhe të Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB). Të treja këto institucione do të ristrukturohen në kuadër të procesit të reformës, duke i kaluar të gjitha funksionet dhe kompetencat e inspektoratit në një strukturë të vetme qendrore të inspektoratit. Aktualisht, nuk ekziston një pezullim i përgjithshëm i punës së AKU-së, por është vendosur pezullim i inspektimeve të paplanifikuara, në pritje të ristrukturimeve dhe përshtatjeve të nevojshme sipas ligjit të ri. Inspektimet e planifikuara dhe të miratuara nga titullari i AKU-së po kryhen në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me planet operationale të miratuara. Vendimi për pezullimin e inspektimeve të paplanifikuara është marrë duke marrë parasysh rritjen e ndjeshme të ankesave nga subjekte të ndryshme për qasjen dhe sjelljen e inspektorëve, mungesën e planeve operationale të argumentuara si dhe përgatitjet e nevojshme për implementimin e Ligjit nr. 99/2024. Në këtë kontekst, po punohet për adresimin e praktikave të mundshme abuzive gjatë ushtrimit të detyrave inspektuese, si dhe për rishikimin e mekanizmave të koordinimit midis strukturave rajonale dhe qendrore të AKU-së, me qëllim zbatimin e standarteve të unifikuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Njëherësh, prioritet i reformës mbetet garantimi i transparencës dhe përmbushja e standardeve ligjore dhe kërkesave të subjekteve të veprimtarisë së AKU-së. Për të siguruar një proces të drejtë dhe të efektshëm, është ngritur një grup pune për vlerësimin e performancës së drejtuesve dhe inspektorëve të AKU-së. Ky grup pune do të përfshijë ekspertizën e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), që do të sigurojë vlerësim profesional dhe të pavarur. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është në proces të hartimit të një plani pune të detajuar për vijimin e procedurave dhe marrjen e vendimeve të mëtejshme në funksion të realizimit të reformës së inspektoratit.		
--	--	--	---	--	--

41.	9.7.2025	Na vendosni ne dispozicion fushen se si ka shkuar fondi ne funksion te marreveshjes me BERZH sic eshte dnertimi I kapaciteteve, fushata e informimit dhe sa kredi ne dispozicion te biznesit A ka patur komunikime me BERZH MBZHR per ecurine e kesaj linje kredie lidhur me performacene saj ne funksion te qellimit per ndihmen e sektorit te agrobiznesit? Numrin dhe Shumen e perfituesve nuk e ka raportuar BERZH pas kerkeses suaj per kete ecuri apo nuk ka patur ndonjehere kerkese nga ana institucionit tuaj?	18.7.2025	Ne pergjigje te kerkeses suaj per informacion ju bejme me dije se në kuadër të bashkëpunimit institucional të vazhdueshëm me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përmes strukturave përkatëse, ka mbajtur komunikim të rregullt dhe të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e BERZH, me qëllim ndjekjen e ecurisë së marrëveshjes së bashkëpunimit dhe shkëmbimin e informacionit mbi aktivitetet konkrete të realizuara në terren. Ky bashkëpunim fokusohet veçanërisht në ndërtimin e kapaciteteve, ofrimin e asistencës teknike për agrobiznesin dhe sektorin e turizmit rural, si dhe lehtësimin e aksesit në financim për sipërmarrjet përkatëse. Ministria është angazhuar për të siguruar një pasqyrë të plotë të përfituesve, komponentëve të zbatimit dhe impaktit të mbështetjes në kuadër të kësaj marrëveshjeje. Sa i përket informacionit të detajuar të kërkuar mbi numrin e subjekteve përfituese, mënyrën e shpërndarjes së fondit sipas komponentëve (ndërtim kapacitetesh, fushata informimi, mbështetje financiare etj.), ju informojmë se aktualisht jemi në pritje të përditësimit zyrtar nga BERZH për të dhënat që i përkasin tremujorit të fundit. Këto të dhëna do të na mundësojnë të kemi një pasqyrë të plotë dhe të saktë mbi zbatimin e marrëveshjes. Sapo të na vihet në dispozicion ky informacion i përditësuar, do të vijojmë menjëherë me përcjelljen e informacionit te kerkuar.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
42	16.7.2025	Cili është afati konkret i pritshëm për rifillimin e financimeve IPARD III në terren për fermerët shqiptarë? A ka ndonjë datë të përafërt për hapjen e aplikimeve? Çfarë masa konkrete janë marrë për të adresuar gjetjet e OLAF lidhur me	22.7.2025	Cili është afati konkret i pritshëm për rifillimin e financimeve IPARD III në terren për fermerët shqiptarë? Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është e angazhuar maksimalisht dhe po zbaton një plan veprimi me masa konkrete, dakordësuar me strukturat të Komisionit Evropian. Gjithashtu po kryhet një auditim i jashtëm, i cili është në fazë zbatim dhe rezultatet e të cilit priten brenda këtij viti. Me përfundimin e auditimit të jashtëm do të kryhen procedurat, në zbatim të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

	keqpërdorimet e konstatuara në IPARD II? A ka pasur hetime administrative apo ndëshkime për individët ose subjektet e përfshira? Si funksionon sistemi i ri i monitorimit në kohë reale pranë AZHBR-së? A është ky sistem certifikuar nga ndonjë autoritet i pavarur? Çfarë kriteresh të reja do të aplikohen në përzgjedhjen e përfituesve në IPARD III për të shmangur favorizimet politike ose konfliktet e interesit? Në çfarë mase janë përfshirë grupet e interesit dhe fermerët në hartimin e masave të reja për IPARD III? A do të ndryshojë roli i kompanive konsulente në procesin e aplikimit për IPARD III? A do të ketë rregulla të reja për transparencën e kontratave dhe tarifave?	(miratuar me ligjin 65/2022) dhe Marrëveshjes Sektoriale (miratuar me ligjin 97/2022). A ka ndonjë datë të përafërt për hapjen e aplikimeve? Në përfundim të auditimit dhe përmbushjes së rekomandimeve të dhëna, do të finalizohet Marrëveshja e Financimit për Programin IPARD III dhe më pas do të hapen thirrjet për aplikime. Çfarë masa konkrete janë marrë për të adresuar gjetjet e OLAF lidhur me keqpërdorimet e konstatuara në IPARD II? Në kuadër të zbatimit të planit të veprimit janë ndërmarrë masa të rëndësishme për forcimin e kontrollit dhe transparencës në zbatimin e programit IPARD. Me VKM nr. 275, datë 9.5.2025, është miratuar Strategjia Kombëtare kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiarë të Bashkimit Evropian 2025–2030, së bashku me planin përkatës të veprimit. Gjithashtu, është duke u reformuar struktura e AZHBR, rriten kapacitetet njerëzore përmes trajnimeve, po punohet për funksionalizimin e platformës elektronike “e-application” për dixhitalizimin e aplikimeve, dhe po testohet databaza me çmimet referencë për investimet në bujqësi. A ka pasur hetime administrative apo ndëshkime për individët ose subjektet e përfshira? Nuk kemi informacion mbi ndonjë hetim administrativ ose masë ndëshkimore lidhur me këtë çështje. Si funksionon sistemi i ri i monitorimit në kohë reale pranë AZHBR-së? AZHBR ka implementuar disa sisteme të integruara për procesimin e aplikimeve, pagesave dhe raportimit, të cilat janë të dizajnuara për të siguruar përmbushjen e kërkesave të Bashkimit European në lidhje me monitorimin dhe raportimin. Këto sisteme janë pjesë e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të agjencisë, dhe funksionojnë në harmoni me përgjegjësitë dhe detyrat që kryen Agjencia e Pagesave. Përmes këtyre sistemeve, AZHBR siguron mbledhjen dhe përpunimin në kohë reale të të dhënave të nevojshme për menaxhimin efikas të fondeve dhe zbatimin e politikave bujqësore dhe rurale.		
--	--	---	--	--

43	22.7.2025	A eksizton ndonje projekt i miratuar apo qe po planifikohet te implementohet per ujitje ne njesine administrative Derjan ne Mat. Nese po lutem ten a dergoni nje kopje elektronike. Ne rast se nuk ekziston nje project i tille, ju lutem a mund ten a beni me dije se cilat jane hapat administrative qe duhen ndjekur prane intitucionit tuaj dhe atij vendor, per hartimin e nje kerkese nga komuniteti lokal.	25.7.2025	Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 30.12.2015 <i>“Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”</i>, i ndryshuar, e gjithë infrastruktura e ujitjes, perfshire skema e ujitjes objekt I kerkeses Tuaj, i është transferuar në pronësi Bashkisë Mat. Nga Bashkia Mat, janë kërkuar për financim në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 3 projekte për infrastrukturën e ujitjes si më poshtë: 1. Rehabilitimi i kanalit ujitës të Sekës, me vlerë të plotë të projektit 89,917,260 lekë; 2. Rehabilitimi i kanalit ujitës të ujëmbledhësit të Bazit nr. 2, me vlerë të plotë të projektit 98,399,399 lekë; 3. Rehabilitimi i kanalit ujitës Urake, me vlerë të plotë të projektit 23,869,027 lekë. Lidhur me pikën e parë të kërkesës Tuaj, për çdo projekt të miratuar per tu investuar apo që planifikohet të implementohet për ujitje në Njësinë Administrative Derjan, në Mat, lutemi drejtohuni Bashkisë Mat për tërheqjen e kopjes së tyre, pasi Bashkia Mat harton projektet për financim në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit ne territorin e saj. Lidhur me pikën e dytë të kërkesës Tuaj, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural do të konsiderojë mundësinë e financimit e projekteve te kerkuara nga bashkite dhe te shoqeruara me projektin perkates, në periudhën në vijim me PBA (Plani i buxhetit afatmesëm) 2026 – 2028.	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0

44	4.8.2025	Në kuadër të një analize që po përgatitet lidhur me masat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive në blegtori, ju lutem të na vini në dispozicion një kopje të Urdhrit nr. 802, datë 9.10.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontigjencës për Sëmundjen e Murtajës së Ruminantëve të Vegjël”, me qëllim përdorimin si referencë teknike në materialet tona.	20.8.2025	 Plani i kontigjences per Murtajen e Rum	Përgjigja i është dhënë e plotë.	0
45	22.9.2025	Referuar vendimeve të mëposhtme 1. VKM Nr. 320, datë 31.5.2023 PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË TRAJTIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE NË PËRDORIM, NË KUSHTET E NENIT 12, TË LIGJIT NR. 20/2020 2. VENDIMIT Nr. 320, datë 29.5.2024 PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 320, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË TRAJTIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE NË PËRDORIM, NË KUSHTET E NENIT 12, TË LIGJIT NR. 20/2020” Në zbatim te nenit 3 dhe nenit 14 të VKM Nr. 320, datë	30.9.2025	Ne pergjigje te kerkeses suaj per informacion ne lidhje me veprimtarine e task forces se ngritur me vendimin nr. 320/2023 te Keshillit te Ministrave “Për ngritjen e Task-Forcës për koordinimin e procesit të trajtimit të tokave bujqësore në përdorim, në kushtet e nenit 12, të ligjit nr. 20/2020” ju bejme me dije se: Task forca drejtohet nga kryetari dhe ka në përbërje të saj deri në njëpërfaqësues të secilit prej institucioneve të mëposhtme: a) Agjencia Shtetërore e Kadastrës; b) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë; ç) Ministria e Drejtësisë; d) Agjencia e Trajtimit të Pronës; - dh) Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor. MBZHR si nje nga perfaqesuesit e kesaj njesie ben me dije se Task Forca për Tokën Bujqësore ka vepruar vetem në territorin e qarkut Shkodër, duke zbatuar te gjitha detyrat e përcaktuara ne vendimin e sipercituar, për të bërë të mundur trajtimin e kërkesave për kalimin e tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi. Gjatë këtij procesi, Task-Forca ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha institucionet e përfshira, duke përfshirë edhe bashkitë e Qarkut Shkodër, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), dhe Drejtorinë e Administrimit dhe	Përgjigja i është dhënë e plotë	0

		31.5.2023 cilët janë njësitë administrative territoriale të vecanta ku është krijuar Task-Forca per Qarkun KUKËS dhe SHKODER .		Mbrojtjes se Tokes (DAMT), duke evidentuar poseduesit faktikë të tokës bujqësore. Po ashtu, janë organizuar takime të përsëritura me Njësitë e Vlerësimit të Vlerës (NJVV), DAMT dhe institucione të tjera, me qëllim koordinimin e procesit, në përputhje me rrethanat dhe problematikat e konstatuara. Për informacion të mëtejshëm dhe më të detajuar, ju lutemi t'i drejtoheni Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, ushtron rolin e sekretariatit teknik të Task-Forcës.		
46	23.9.2025	Në kuadër të raportimit tonë mbi procesin e negociatave për Grupkapitullin 5, kemi marrë konfirmime nga burime të ndryshme diplomatike pranë Këshillit të BE-së dhe delegacioneve të Gjermanisë dhe Holandës, të cilat në mënyrë të përmbledhur theksojnë se: • Procesi i diskutimeve në COELA për Grupkapitullin 5 është ende në zhvillim dhe mbetet konfidencial; • Gjermania mbështet plotësisht zgjerimin, por vëmendje e veçantë po i kushtohet transparencës dhe luftës kundër korrupsionit; • Holanda po ndjek me kujdes përdorimin e fondeve bujqësore nga autoritetet shqiptare, por	30.9.2025	 pergjigje.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë	0

		nuk e konsideron veten si bllokuese të hapjes së kapitullit. Duke marrë parasysh këto qëndrime joformale, a mund të na jepni një koment zyrtar nga Ministria: • <i>Si i vlerësoni këto sinjale nga vendet anëtare dhe a keni pasur ndonjë komunikim zyrtar mbi këtë çështje?</i> • <i>Cili është qëndrimi i Ministrisë në lidhje me hetimin e OLAF-it për fondet e programit IPARD II dhe çfarë masash janë ndërmarrë pas tij?</i> • <i>A janë përmirësuar kapacitetet institucionale dhe mekanizmat e monitorimit të fondeve bujqësore në raport me kërkesat e BE-së?</i> • <i>Si po përgatitet Ministria për fazën e ardhshme të negociatave në këtë fushë dhe a ka patur komunikime të drejtpërdrejta me delegacionet e vendeve anëtare që kanë shprehur shqetësime?</i>				
--	--	---	--	--	--	--

47	15.9.2025	A ka punësuar institucioni juaj staf të përkohshëm gjatë dy viteve të fundit? - Nëse po: a) A janë rekrutuar këta punonjës përmes shpalljeve të hapura të vendeve të lira? b) Ju lutem dërgoni dosjen* e plotë të rekrutimit për punësimin e fundit të përkohshëm për kategoritë e nëpunësve civilë dhe punonjësve të kontraktuar jashtë shërbimit civil. (<i>*Dosja përfshin: shpalljen, listat e kandidatëve, proces-verbalet e vlerësimit dhe vendimin përfundimtar</i>). Sa është numri aktual i përgjithshëm i nëpunësve civilë dhe i punonjësve të tjerë në institucion? Sa është numri aktual i personelit të punësuar përkohësisht?	1.10.2025	 kthim pergjigje.docx	Përgjigja i është dhënë e plotë	0
48.	30.9.2025	Referuar pikes 3 te nenit 40 te LIGJIT Nr. 24/2017 PËR ADMINISTRIMIN E UJITJES DHE TË KULLIMIT: <i>“ Forma dhe përmbajtja e regjistrave në këtë nen përcaktohen me urdhër të ministrit” .</i>	6.10.2025	Ne pergjigje te kerkeses suaj per informacion me poshte gjendet link i publikimit te akteve te miratuara ne faqen zyrtare te Qendres se Botimeve Zyrtare. https://www.qbz.gov.al/eli/urdher/2019/12/30/697/45b7d890-39ae-4af2-b0d0-91f8dcb6f24f https://www.qbz.gov.al/eli/udhezim/2019/12/30/12/82d92cd8-5f11-4dcb-971f-6e94f8bfbebe	Përgjigja i është dhënë e plotë	0

		Kërkoj të njihem me një kopje të urdhërit të Ministrit të Bujqësisë të dalë në zbatim të këtij neni.				
49.	24.9.2025	1. Sa punonjës kanë kërkuar lejen vjetore në periudhën 1 Janar 2025 deri në 15 Maj 2025? Ju lutem informacionet të na i dërgoni të ndara sipas muajve. 2. Sa prej këtyre lejeve të kërkuara janë aprovuar për 1 Janar 2025 deri në 15 Maj 2025? Ju lutem informacionet të na i dërgoni të ndara sipas muajve. 3. A ka pasur raste kur punonjësit kanë kërkuar leje vjetore pa të drejtë page gjatë periudhës 1 Janar 2025 deri në 15 Maj 2025? Nëse po, sa leje janë aprovuar? Ju lutem informacionet të na i dërgoni të ndara sipas muajve. 4. Sa punonjës kanë paraqitur raport mjekësor gjatë periudhës 1 Janar 2025 deri në 15 Maj 2025? Ju lutem informacionet të na i dërgoni të ndara sipas muajve dhe periudhave përkatëse.	7.10.2025	 pergjigje (2).docx	Përgjigja i është dhënë e plotë	0
50.	20.10.2025	1- Cilat janë masat e marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për të mbrojtur	3.11.2025	1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është e angazhuar maksimalisht dhe po zbaton një plan veprimi me masa konkrete, dakordësuar me strukturat të Komisionit Evropian. Gjithashtu, është kryer një auditim i jashtëm i pavaruar dhe Raporti Përfundimtar i tij është dorëzuar pranë Komisionit Evropian. Në zbatim të	Përgjigja i është dhënë e plotë	0

	dhe përdorur me transparencë fondet e IPARD? 2- Si do të parandalohen në të ardhmen raste të abuzimeve me fondet e BE? 3- Nga shkeljet e konstatuara nga OLAF për IPARD II, sa prej atyre rasteve keniverifikuar? Çfarë ka ndodhur me paratë e fituara me pa të drejtë? 4- KE në një përgjigje për Report TV pak javë më parë, tha se qeveria shqiptare duhet ta trajtojë me seriozitet çështjen e IPARD, që të vendoset zhbllokimi i parave. Në çfarë faze janë diskutimet me KE, për zhbllokimin e fondeve? (https://reporttv.al/lajm/ekskluzive-ska-para-per-bujqesine-pa-garancise-fondet-mbrohen-be-per-report-tv-bllokimi-i-ipard-iii-mbetet-merreni-seriozisht) 5- A ka Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural një afat se kur pritet të hapen fondet e IPARD III?		Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit (miratuar me ligjin 65/2022) dhe Marrëveshjes Sektoriale (miratuar me ligjin 97/2022), do të vijohet me hapat e mëtejshëm. 2. Qeveria Shqiptare po punon në drejtim të forcimit të mekanizmave të kontrollit dhe auditimit; rritjen e transparencës në çdo hallkë të procesit të zbatimit të programeve të ardhshme të IPARD si dhe masave parandaluese dhe ndëshkuese në përputhje me standardet e BE-së. Në kuadër të zbatimit të planit të veprimit janë ndërmarrë masa të rëndësishme për forcimin e kontrollet dhe transparencës në zbatimin e programit IPARD. Me VKM nr. 275, datë 9.5.2025, është miratuar Strategjia Kombëtare kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian 2025–2030, së bashku me planin përkatës të veprimit. Gjithashtu, është duke u reformuar Agjencia e Pagesave, po rriten kapacitetet njerëzore përmes trajnimeve, po punohet për funksionalizimin e platformës elektronike “e-application”, për dixhitalizimin e aplikimeve dhe po testohet databaza me çmimet referencë për investimet në bujqësi. Gjithashtu, në kuadër të angazhimeve të autoriteteve shqiptare për forcimin e masave për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian, Ministria e Financave/Zyrtari Kombëtar Autorizues ka miratuar një udhëzues specifik për menaxhimin e konfliktit të interesit për zbatimin e programeve IPA dhe IPARD. 3. Janë ndërmarrë veprimet korrigjuese për projektet të cilat janë pjesë e raportit OLAF për rikuperimin e fondeve në zbatim të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit (miratuar me ligjin 37/2015) dhe Marrëveshjes Sektoriale (miratuar me ligjin 30/2016), do të vijohet me hapat e mëtejshëm. 4. Është përmbyllur auditimi i jashtëm i pavarur, dhe Raporti Përfundimtar i tij është dorëzuar pranë Komisionit Evropian. Me qëllim shqyrtimin e rekomandimeve dhe integrimin e tyre në planin e veprimit është ngritur një grup pune. Ky auditim përbën	
--	--	--	--	--

				gjithashtu një element thelbësor për procesin e vlerësimit të akreditimit të programit IPARD III. 5. Në përmbyllje të rekomandimeve të auditimit do të vijojë zbatimi i procedurave përkatëse, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit (miratuar me ligjin nr. 65/2022) dhe Marrëveshjes Sektoriale (miratuar me ligjin nr. 97/2022). Në lidhje me afatet e hapjes së Programit IPARD III, informacioni zyrtar do të publikohet në faqet www.bujqesia.gov.al dhe www.ipard.gov.al. Në momentin e shpalljes së thirrjeve për aplikim, do të bëhet publik edhe kalendari i fushatave të informimit si dhe udhëzuesi për aplikantët, të cilët do të jenë të aksesueshëm në këto platforma zyrtare.		
51.	8.10.2025	1. A janë aktualisht funksionalë laboratorët shtetërorë të analizave bujqësore dhe ushqimore në Fier dhe Berat? Nëse jo, kur dhe për çfarë arsye janë mbyllur? 2. Në mungesë të laboratorëve shtetërorë në këto qytete, a duhet fermerët dhe operatorët e agrobiznesit të udhëtojnë drejt qyteteve të tjera për të kryer analizat? Apo janë marrë masa për ofrim alternativ të këtyre shërbimeve? 3. Pse aktualisht analizat e produkteve bujqësore dhe ushqimore po kryhen pothuajse vetëm në laboratorë privatë, me kosto të larta për fermerët? A	27.10.2025	1. Në vijim të interesimit tuaj, sqarojmë se Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) Fier dhe Berat kryen analizimin e mostrave në Sektorin e Shërbimeve Laboratorike të AKU Fier. Në përputhje me kapacitetet ekzistuese, ky sektor ofron shërbime vetëm për efekt të kontrollit zyrtar. 2. Siç është theksuar më sipër, analizat laboratorike të mostrave zhvillohen në Sektorin e Shërbimeve Laboratorike të AKU Fier. Gjithashtu, bëjmë me dije se lista e laboratorëve të akredituar, si dhe shërbimet e ofruara prej tyre, janë të publikuara në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA), në adresën elektronike: www.dpa.gov.al 3. Në përgjigje edhe të pyetjeve të mësipërme ju bëjmë me dije se Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) Fier dhe Berat vazhdon të kryejë analizimin e mostrave në Sektorin e Shërbimeve Laboratorike të AKU Fier. 4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kryen analizimin e mostrave në kuadër të kontrollit zyrtar, bazuar në Planin Vjetor Kombëtar të Marrjes së Mostrave, i hartuar mbi bazën e vlerësimit të riskut. Ky plan përfshin:	Përgjigja i është dhënë e plotë	0

		është kjo një zgjidhje e përkohshme apo pritet të ndërmarren masa të tjera në vazhdim? 4. Mungesa e këtyre laboratorëve shtetërore a përbën factor rreziku për shtimin e rasteve të ngarkesaave të ndaluara me produkte bujqësore që përmbajnë tejkalim të normave të lejuara të pesticideve?		a) ushqimin për konsum njerëzor, b) ushqimin për kafshë, c) mbrojtjen e bimëve dhe inputet bujqësore, d) si dhe marrjen e mostrave në Pikat e Inspektimit Kufitar, në kuadër të monitorimeve periodike apo rasteve emergjente. Gjithsesi duhet theksuar fakti që në përputhje me ligjin për ushqimin, operatorët e biznesit ushqimor kanë detyrimin ligjor për të garantuar që në treg të hidhen vetëm produkte të sigurta për konsumatorin. Sa i përket pyetjes Tuaj për sasinë e vajit të ullirit të prodhuar në vitin 2024, nga të dhënat statistikore për MBZHR rezulton 35 632 ton.		
52.	3.11.2025	Per nevoja te procesit gjyqesor per njohjen dhe kompensimin e prones, lutem me vendosni ne dispozicion Kopje te Udhezimit Nr. 2 date 03.11.1995 te Ministrit te Bujqesisë dale ne zbatim te VKM Nr. 560 datë 16.10.1995 “Për masat për zbatimin e ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”.	5.11.2025	 udhezimi.pdf	Përgjigja i është dhënë e plotë	0
53.	6.11.2025	1. Çfarë masash administrative, monitoruese apo disiplinore ka marrë Ministria pas vendimit të Komisionit Evropian për pezullimin e përkohshëm të Programit IPARD II në Shqipëri? 2. A është ngritur nga Ministria ndonjë grup pune apo audit i brendshëm për të shqyrtuar rastet e	19.11.2025	1. Autoritetet shqiptare, strukturat IPARD, kanë ndërmarrë masa të menjëhershme për përmirësimin e administrimit dhe transparencës së programit. Është hartuar një plan veprimi në bashkëpunim me Komisionin Evropian, me synim adresimin e të gjitha rekomandimeve dhe rikthimin e plotë të zbatimit të programit. Plani i veprimit për forcimin e transparencës dhe integritetit në zbatimin e fondeve IPARD, po zbatohet nga strukturat IPARD. Komisioni Evropian ka vlerësuar pozitivisht	Përgjigja i është dhënë e plotë	0

	dysuara për abuzime në zbatimin e programit IPARD II? 3. Cilat janë institucionet shqiptare me të cilat Ministria ka bashkëpunuar për këtë çështje (p.sh. AZHBR, Ministria e Financave, Prokuroria, OLAF, Delegacioni i BE-së)? 4. A ka Ministria në zotërim raporte apo njoftime zyrtare të ardhura nga Komisioni Evropian ose Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) lidhur me gjetjet e auditimit? #Nëse po, kërkojmë kopje ose përmbledhje zyrtare të këtyre komunikimeve. 5. Sa është vlera totale e fondeve të padisbursuara nga IPARD II deri në momentin e pezullimit të programit? 6. A ka Ministria marrë masa për rishikimin e akreditimit të AZHBR-së si agjenci zbatuese e programeve IPARD në Shqipëri? 7. A është hartuar një plan masash për ristrukturimin ose forcimin e kontrollit mbi menaxhimin e fondeve të ardhshme të BE-së në bujqësi? 8. A është pezulluar përkohësisht apo vijon përgatitja e fazës IPARD	masat e ndërmarra, të cilat pasqyrojnë angazhimin e qëndrueshëm të autoriteteve IPARD për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të OLAF. Në këtë kuadër, janë përmbushur hapat kryesorë ku është finalizuar auditimi i jashtëm i pavarur; është miratuar me VKM nr. 275, datë 9.5.2025 “Strategjia Kombëtare kundër Mashtrimit 2025–2030”, ndërsa vijon në mënyrë të sistematike forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në të gjitha strukturat IPARD. 2. Plani i Veprimit, hartuar për adresimin e mangësive dhe mospërputhshmërive të konstatuara gjatë zbatimit të programit IPARD II, të ngritura nga OLAF kanë qenë subjekt i një auditimi të jashtëm i pavarur. Procesi auditimit është përmbyllur dhe Raporti Përfundimtar i tij është dorëzuar pranë Komisionit Evropian (DG AGRI). Për shqyrtimin e rekomandimeve dhe integritimin e tyre në planin e veprimit është ngritur një grup pune nga Zyrtari Kombëtar Autorizues. 3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të gjithë strukturat shqiptare janë në bashkëpunim dhe në koordinim të vazhdueshëm me strukturat përkatëse të Komisionit Evropian për përgatitjen dhe zbatimin e Planit të Veprimit për adresimin e gjetjeve të raportit të OLAF dhe raportimi bëhet mbi baza 2 mujore në strukturat e K.E. 4. Raporti Final i Hetimit (Abstrakt) është dorëzuar pranë Autoriteteve Shqiptare dhe është klasifikuar si “rreptësisht konfidencial”. Në përputhje me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në raport, është hartuar Plani i Veprimit, i cili është vlerësuar nga Komisioni Evropian si i pranueshëm. Ky plan parashikon adresimin e gjetjeve të identifikuara dhe është në proces zbatimi nga strukturat shqiptare me raportime periodike çdo dy muaj. Plani i Masave ka qenë objekt i një auditimi të jashtëm dhe të pavarur, i cili është realizuar nga Ministria e Financave. Raporti Përfundimtar i auditimit është klasifikuar si konfidencial. Procesi i auditimit është përmbyllur me sukses dhe		
--	--	--	--	--

	III dhe cilat janë afatet e planifikuara për nisjen e saj? 9. A ka Ministria të dhëna mbi fermerë apo biznese që kanë marrë miratimin për financim, por nuk kanë përfituar pagesën për shkak të pezullimit të programit? #Nëse po, kërkojmë numrin e rasteve dhe vlerën totale të fondeve të papaguara. 10. Cilat janë masat që Ministria po ndërmerr për të mbrojtur përfituesit korrektë dhe për të garantuar që procesi i IPARD të vijojë pa dëmtuar fermerët që kanë investuar? 11. A është parashikuar ndonjë mekanizëm kompensimi ose mbështetje alternative nga buxheti i shtetit për përfituesit që kanë mbetur pa pagesë pas pezullimit? 12. A ka Ministria marrë ndonjë vendim për informimin publik ose publikimin e të dhënave mbi përfituesit e IPARD II dhe statusin e projekteve të tyre pas pezullimit?	Raporti Përfundimtar është dorëzuar pranë Komisionit Evropian (DG AGRI). 5. Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe rural, Programi IPARD II ka përfunduar zyrtarisht në dhjetor 2023. Programi ka synuar nxitjen e konkurrueshmërisë në bujqësi, përmirësimin e standardeve të prodhimit dhe përkrahjen e zhvillimit të qëndrueshëm rural në vend. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratat përkatëse, procesi i kryerjes së pagesave për projektet e përfunduara ka vijuar deri në dhjetor 2024. 6. Po vijon zbatimi i Planit të Veprimit për adresimin e mangësive dhe mospërputhshmërive të konstatuara gjatë zbatimit të Programit IPARD II. Ky proces zhvillohet në përputhje me kërkesat dhe standardet e Bashkimit Evropian, me qëllim forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e mekanizmave të menaxhimit dhe kontrollit. Raporti i auditimit të jashtëm dhe të pavarur, si dhe zbatimi i rekomandimeve të tij, do të shërbejnë si bazë për vlerësimin e akreditimit të Programit IPARD III, në kuadër të vazhdimësisë së mbështetjes së Bashkimit Evropian për zhvillimin e qëndrueshëm rural në Shqipëri. 7. Siç është përmendur më herët, është hartuar dhe po zbatohet Plani i Veprimit për adresimin e mangësive dhe mospërputhshmërive të konstatuara gjatë zbatimit të Programit IPARD II. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë masa konkrete për forcimin e kontrollit, transparencës dhe integritetit në proceset e zbatimit të programit. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 275, datë 9 maj 2025, është miratuar Strategjia Kombëtare kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiarë të Bashkimit Evropian 2025–2030, së bashku me Planin përkatës të Veprimit. Paralelisht, po vijon reformimi i Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural		
--	---	---	--	--

			(AZHBR), me synim rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e standardeve të menaxhimit. Janë forcuar strukturat e kontrollit për evidentimin e pasaktësive, parregullsive apo çdo forme tjetër që mund të cenojë investimet në mbështetje të fermerëve shqiptarë. Njëkohësisht, po rriten kapacitetet njerëzore përmes programeve të trajnimit dhe specializimit, ndërsa po punohet për funksionalizimin e platformës elektronike “e-Application” për dixhitalizimin e aplikimeve. Gjithashtu, është në fazë testimi databaza me çmimet referuese për investimet në bujqësi, e cila do të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe parandalimin e parregullsive gjatë procesit të zbatimit të programeve mbështetëse. 8. Me përmbushjen e aktiviteteve të Planit të Veprimit dhe të rekomandimeve të Raportit të Auditimit të Jashtëm dhe të Pavarur, do të vijojë zbatimi i procedurave përkatëse në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit (miratuar me ligjin nr. 65/2022) dhe të Marrëveshjes Sektoriale (miratuar me ligjin nr. 97/2022). Sa i përket afateve të hapjes së Programit IPARD III, informacioni zyrtar do të publikohet në faqet www.bujqesia.gov.al dhe www.ipard.gov.al Në momentin e shpalljes së thirrjeve për aplikim, do të bëhet publik edhe kalendari i fushatave të informimit, si dhe udhëzuesi për aplikantët, të cilët do të jenë të aksesueshëm në këto platforma zyrtare. Gjithashtu, të gjitha strukturat përgjegjëse për zbatimin e Programit IPARD vijnë në përgatitjet për masat e reja të parashikuara në program, me qëllim sigurimin e një zbatimi efektiv, transparent dhe në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. 9. Si përmendur në pikën 5, strukturat IPARD kanë vijuar kryerjen e pagesave për të gjitha projektet e përfunduara brenda		
--	--	--	---	--	--

				afateve dhe në përputhje me legjislacionin dhe kontratën përkatëse. 10. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural po ndërmerr një sërë masash për të mbrojtur përfituesit korrektë të programeve IPARD dhe për të garantuar vijueshmërinë e mbështetjes pa cënuar interesat e fermerëve që kanë investuar. Në këtë kuadër, janë organizuar fushata të dedikuara informimi dhe komunikimi me të gjithë përfituesit, me qëllim shpërndarjen e informacionit të saktë, rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit mbi vazhdimësinë e mbështetjes financiare. Gjithashtu, Ministria po forcon mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit, për të siguruar që çdo përfitues që ka vepruar në përputhje me rregullat dhe kontratat përkatëse të mos dëmtohet nga proceset administrative dhe të ketë mbështetjen e programit. 11. Referoju pikës 9. 12. Në zbatim të Marrëveshjes Sektoriale (ratifikuar me ligjin nr. 30/2016), Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), publikon në faqen e saj zyrtare www.azhbr.gov.al, si dhe në faqen e dedikuar për Programin www.ipard.gov.al, listën e operacioneve dhe të përfituesve të Programit IPARD II, sipas thirrjeve për aplikime. Gjithashtu, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes, çdo projekt verifikohet dhe kontrollohet ex-post gjatë periudhës pesë-vjeçare pas marrjes së pagesës së fundit. Këto masa synojnë të garantojnë transparencë, integritet dhe monitorim të vazhdueshëm të investimeve të mbështetura përmes fondeve të IPARD II.		
54.	27.11.2025	1. Cila nga dispozitat në fjalë ka prevalencë në zbatim sipas interpretimit zyrtar të Ministrisë së Bujqësisë & Zhvillimit Rural, VKM Nr.434, datë 11.07.2018 apo Urdhër Nr.806, datë 14.08.2025 MBZHR? (Pretendohet që aktet ligjore sipërcituar të kenë	18.12.2025	Së pari, sqarojmë se Vendimi nr. 434, datë 11.07.2018, i Këshillit të Ministrave “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit” (në vijim “VKM”), është nxjerrë në zbatim të ligjit për ushqimin, ndërsa Urdhri i Ministrit nr. 806, datë 14.08.2025, “Për rregullat shtesë specifike për etiketimin e produkteve të verës” (në vijim “urdhri”), është nxjerrë në zbatim të ligjit për vreshtarinë dhe verën. Këto akte përbëjnë akte nënligjore që përmbajnë rregullime përgjithësisht	Përgjigja i është dhënë e plotë	0

	rrjedhshmëri nga Ligji Nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar dhe Ligj Nr.86/2022 “Për Vreshtarinë dhe Verën”) 2. Në rastet kur nevojitet një përmirësim i një akti ligjor në fuqi siç është VKM Nr.434, datë 11.07.2018 e cila përmban në mënyrë të detajuar procedurën e etiketimit të produkteve ushqimore në zbatim të Ligjit Nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar vlen nxjerrja e një Urdhëri Ministrie apo duhet të kryhet përditësimi i VKM-së në fuqi? 3. Nëse ekziston ndonjë akt nënligjor, udhëzim apo interpretim zyrtar i miratuar që sqaron këtë mospërputhje dhe rregullon konfliktin midis këtyre normave? 4. Si do veprohet në raste e produkteve të Verës së Importuar ku legjislacioni i vendit nga ato vijjnë nuk e përmban deklaratën e vlerave ushqyese, dhe datën e jetëgjatësisë minimale? 5. A ka filluar aplikimi dispozitave ligjore të përmendura tek Urdhëri Nr.806, datë 14.08.2025 në lidhje me etiketimin për produktet e verës që operojnë në	komplementare dhe nuk bien në kundërshtim me njëri-tjetrit. Për rrjedhojë, nuk lind nevoja për përcaktimin e prevalencës së njërit akt ndaj tjetrit. Edhe në rastet kur rregullimet nuk janë plotësisht komplementare dhe kur parashikohet formulimi “pa rënë ndesh me rregullimet e legjislacionit në fuqi”, zbatohet dispozita e aktit që përmban rregullime specifike për produktin përkatës, siç është rasti i produkteve të verës. Gjithashtu në bazë të nenit 14 "Importi" të Ligjit Nr.9863 "Për ushqimin", të ndryshuar, citohet se: “1. Ushqimi i importuar në Republikën e Shqipërisë nxirret në treg kur plotëson kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. 2. Në rastin e marrëveshjeve të veçanta ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendit eksportues, ushqimi i importuar në Republikën e Shqipërisë nxirret në treg kur plotëson kërkesat e përcaktuara në këto marrëveshje” VKM përcakton rregullat e përgjithshme për etiketimin e ushqimeve, përfshirë pijet alkoolike dhe verërat, ndërsa urdhri i ministrit përcakton rregulla shtesë specifike për etiketimin e produkteve të verës. Kjo qasje pasqyrohet qartë që në titullin e urdhrit, ku theksohet se bëhet fjalë për rregulla specifike shtesë, në plotësim të atyre të parashikuara në ligjin për vreshtarinë dhe verën, si dhe në VKM për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit, akte këto të referuara shprehimisht edhe në përmbajtjen e urdhrit. Në aspektin e përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, VKM është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 1169/2011, ndërsa urdhri është përafruar me Rregulloren (BE) 2021/2117, si dhe me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2019/33 dhe Rregulloren e Deleguar (BE) 2023/1606, që e ndryshon atë, legjislacioni i cili është ende në fuqi në rendin juridik evropian. Nga pikëpamja përmbajtësore, sqarojmë si më poshtë:		
--	---	--	--	--

		tregun e brendshëm në Republikën e Shqipërisë? 6. Praktikën e ndjekura derimë sot nga Administrata Publike në rastet e ngjashme	– Informacionet e detyrueshme shtesë të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të nenit 3 të urdhrimit të ministrit janë parashikuar në përputhje me kërkesat e Rregullores (BE) 2021/2117, konkretisht pikën 32 (neni 119), shkronja “a”, nënshkronja (ii). Megjithatë neni 16, pika 4, e VKM parashikon se veçoritë e përmendura në shkronjat “b” (lista e përbërësve) dhe “h” (deklarata e vlerave ushqyese) të pikës 1 të nenit 9 nuk janë të detyrueshme për pijet me përmbajtje alkooli mbi 1,2% vëllimor, në fillim të kësaj dispozite parashikohet shprehimisht formulimi “pa rënë ndesh me dispozitat e tjera të legjislacionit në fuqi”. Në këtë rast, dispozitat e legjislacionit të posaçëm, të miratuara më vonë në kohë dhe që përafrojnë një rregullore tjetër të BE-së, parashikojnë detyrimin për vendosjen e këtyre informacioneve në etiketën e produkteve të verës, ndaj këto informacione duhet të pasqyrohen detyrimisht; – Sa i përket “datës së jetëgjatësisë minimale”, urdhri i ministrit i referohet produkteve me një fortësi alkoolike në vëllim më pak se 10%, ndërsa Shtojca X e VKM parashikon se ky informacion nuk është i detyrueshëm për pijet që përmbajnë 10% ose më shumë të vëllimit me alkool. Në këtë kuptim, rregullimet plotësojnë njëra-tjetrën dhe nuk krijojnë kundërshtim apo paqartësi. Për më tepër, shkronja “c” e nenit 3 të urdhrimit i referohet verërave që i janë nënshtruar procesit të dealkoolizimit, të cilat përbëjnë një kategori të rregulluar rishtazi në legjislacionin shqiptar dhe që nuk kanë qenë të parashikuara në kohën e hartimit të legjislacionit të përgjithshëm për ushqimin; – Në lidhje me produktet e importuara, vlerësojmë se rregullimet e VKM dhe të ligjit për vreshtarinë dhe verën janë të harmonizuara. VKM përcakton se përgjegjës për informacionin ushqimor është importuesi, ndërsa ligji për vreshtarinë dhe verën parashikon shprehimisht se, në rastin e verërave të importuara, etiketa duhet të përmbajë edhe emrin e importuesit. Etiketimi i produktit duhet të jetë në përputhje me kërkesat për informacionin e detyrueshëm të vendit të destinacionit, që në këtë rast është Republika e Shqipërisë. Në rast se etiketa origjinale nuk i përmbush këto kërkesa, importuesi mban		
--	--	---	--	--	--

				përgjegjësinë për plotësimin e saj me informacionet që mungojnë. Duke shpresuar se sqarimet e mësipërme u japin përgjigje të plotë të gjitha pyetjeve dhe shqetësimeve të parashtruara, mbetemi në dispozicion për çdo informacion apo sqarim shtesë që mund të nevojitet.		
55.	28.11.2025	1. Sa është sipërfaqja e tokës bujqësore dhe fondit kullosor që është kaluar në përdorim për energjinë diellore? Ju lutem të dhënat të jenë të ndara sipas bashkive 2. Mbi cilat kritere bazohet heqja/zhvendosja e tokës bujqësore si dhe fondit kullosor në përdorime energjetike? A cënon ky “transformim” i tokës, biodiversitetin dhe jetën e komunitetit lokal? 3. A është bërë një vlerësim kumulativ për ndikimin që do të ketë ndryshimi i destinacionit të përdorimit të tokës në të gjithë vendin? A janë parashikuar ndërhyrje rehabilituese të kësaj sipërfaqeje toke, pas përfundimit të kontratës? 4. Ligji për fondin kullosor është ndryshuar në dhjetor 2024, mbi çfarë procedure është lejuar që këto toka të ndryshojnë destinacionin e përdorimit? Lejet e dhëna përpara këtij ndryshime, a janë ato në	18.12.2025	1. Toka bujqësore në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nuk është objekt për veprimtari të energjisë së rinovueshme si dhe nuk ka kaluar për veprimtari të tilla. Toka bujqësore në administrim të MBZHR është objekt qiradhënie për aktivitet bujqësor, blegtoral dhe agroturizëm bazuar tek ligji nr.8318, datë 1.4.1998 ‘Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore’ i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si VKM Nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” e ndryshuar, Lidhur me fondin kullosor, sqarojmë se ky fond nuk është në fushën e veprimtarisë së MBZHR. 2.Ndërtimi i infrastrukturës dhe veprave ndihmëse për zhvillimin, prodhimin, tregtimin, shfrytëzimin, operimin, shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme fotovoltaike dhe eolike dhe ndërtimi i infrastrukturës për vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme lejohet vetëm në tokat bujqësore me kategori bonitet 9 dhe 10, kjo e vërtetuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) pranë Këshillit të Qarkut referuar dokumentacionit të pronësisë, kjo bazuar në shkronjën c) pika 5, neni 14, i ligjit nr 9244 datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar. 3.Ligji nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”, ka parashikuar masat për mbrojtjen e mjedisit gjatë	Përgjigja i është dhënë e plotë	0

		shkelje me ligjin? A do të ketë masa korigjuese në këtë rast?		ndërtimit dhe operimit të projekteve si dhe inkurajon përdorimin e teknologjive të qëndrueshëm dhe minimizimin e ndikimit mjedisor.		
56.	23.12.2025	· Sa është vlera e shpenzuar për bileta avioni dhe akomodim për udhëtimet jashtë shtetit të realizuara për periudhën 01.01.2025-23.12.2025? · Cilët kanë qene destinacionet dhe cilët kanë qenë punonjësit që kanë udhëtuar?	9.1.2026	4. Ashtu sic u shprehëm dhe më lart, fondi kullosor nuk është në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Për çështjet lidhur me fondin kullosor duhet t'i drejtoheni Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. E drejta e informimit është një e drejtë themelore, e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe garantohet përmes ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe përmes ligjit Nr. 45/2022 “Për aksesin në dokumente zyrtare”, që ratifikon Konventën e Këshillit të Evropës në këtë fushë. Qëllimi i këtyre dispozitave ligjore është garantimi i njohjes së publikut me informacionin e autoriteteve publike, duke forcuar legjitimitetin dhe besimin ndaj tyre. Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion lidhur me ushtrimet e punonjësve dhe biletat apo destinacionet, edhe pse ligji për të drejtën e informimit nuk kërkon motivim për kërkesën, kjo nuk duhet të shërbejë si bazë për keqpërdorim apo abuzim të së drejtës për informim. Duke vlerësuar qëllimin e kësaj kërkesë, konstatojmë se ajo nuk plotëson interesin publik dhe nuk realizon ndonjë nga qëllimet e garantuara nga ligji apo standardet evropiane. Prandaj, në përputhje me pikën 5 të nenit 5 të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentat zyrtare”, e ratifikuar me ligjin nr. 45/2022, kjo kërkesë konsiderohet e paarsyeshme.	Përgjigja është refuzuar	0